# Raporti Final

## Vizita ne terren 2012

Qershor 11-12

Permbajtja

faqe

Hyrje 4

Pjesa I Vleresimi institucional 6

1 Deklarata e misionit 6

2 Liria akademike 7

3 Programet Akademik dhe Menaxhimi i studenteve 9

4 Kerkimi shkencor 12

5 Bashkepunimi nderkombetar 13

6 Stafi 14

7 Organizimi, Menaxhimi, Planifikimi 14

8 Financat dhe infrastruktura / Hapesia dhe pajisjet 15

9 Menaxhimi i cilesise 15

10 Konkluzionet 16

Pjesa II Vleresimi i programeve 17

Programet ne ekomomik

- Bachelor 18
- Master 23

Programet ne Banka, Financa and Kontabilitet

- Bachelor 27

- Master 31

Programi ne nderrmarresi dhe zhvillimin lokal

- Master 34

Programet ne menaxhment dhe informatike / marketing

- Bachelor 37
- Master 41

Programet ne shkenca eknomike

- PhD 44

Konkluzionet

Pjesa I 45

Pjesa II 46

# Hyrje

Fakulteti i Ekonomise eshte fakulteti me i madh i Univ it te Prishtines dhe eshte subjekt i vleresimit te cilesise institucionale dhe programore nga aneli i eksperteve nderkombetar.

Vleresimi bazohet ne raportin e vetevleresimit, date shtator 2011, vizit ne terren me 12 Qershor. Sipas zyrtareve Raporti i Vete-vleresimit (SER) eshte shkruar duke respektuar udhezimet e Rektoratit te UP-se per shkrim te raporteve te vete-vleresimit. Fakulteti Ekonomik ka themeluar nje komision per te shqyrtuar re omandimet ne te kaluaren, te analizoj te dhenat dhe ti rishikoj ato ne kontekst te villimeve me te fundit. Nuk jane kerkuar dokumente shtese nga ana e eksperteve. Ekspertet hartuan kete raport ne perputhje me standardet e Agjencise se Akreditimit te soves dhe udhezimet e saj per ekspertet ne lidhje me vleresimin institucional dhe vl resimin e programeve akademike, si dhe kodin e saj te praktikes se mire per vizitat ne terren.

Paneli i eksperteve eshte i vetedijshem se arsimi nuk het ne "izolim te shkelqyer", por eshte pjese e nje kulture kombetare dhe organizative b da nje mjedisi nderkombetar dhe ne ndryshim te vazhdueshem . Panli eshte i vetedijshem per htiresite pengesat dhe ndryshimet dramatike politike gjate viteve te 90-ta dhe qe kjo ka shkaktuar nje vonese ne zhvillim akademik, mungese stafi akademik dh shkurtuar numrin e te diplomuarve.

Ndersa Bologna dhe proceset e Kopenhages jane drejtuesit kryesore te ndryshimit paradigmatic, sistemi i arsimit dhe trajnimit duhet te jete ne pronesi te shoqerise se Kosoves. Per kete arsye paneli ka permbledhur vetem rekomandime te bazuara ne analize te thelle te materialit te paraqitur.Paneli eshte poashtu i vetedijshem qe fakulteti ekonomik eshte vetem nje nga pjeset [10.000 studente] en je Universiteti te madh public [42,000 studente] dhe faktin qe fakulteti duhet te pershtatet mbrenda nj institucioni te madh dhe si rezultat nuk eshte i pavarur. Universiteti i Prishtines eshte nje universitet i integruar.

Ky eshte nje raport i perbashket dhe ne te gjitha rastet eshte metuar te arrihet consensus per permbajtjen mbrenda ekipit. Paneli i eksperteve pe behej nga personat ne vijim me pervoje specifike per programet e fakultetit ku ata is n te fokusuar:

**Paneli i eksperteve**

| Eksperti | Universiteti | Ekspertiza | Programet e fakultetit |
|---|---|---|---|
| Paraskeva Ilieva Dimitrova | Bulgaria Academy of Sciences, Institute of Economics, Bulgaria | Ekonomi | Ekonomiks |
| Patricia Kotnik | University of Ljubljana, Slovenia | Biznes | Banka, Financa, Kontabilitet, Kontabilitet, Ndermarresi dhe zhvillim lokal |
| Wolfgang Georg Arlt | West Coast University of Applied Sciences, Germany | Marketing | Marketing |
| Petri Helo | University of Vaasa, Finland | Teknologji informative | Menaxhment dhe informatike |
| Volker Gehmlich | Osnabruck University of Applied Sciences, | Menaxhim Biznesi | Kryesues |

Paneli ishte i shoqeruar nga stafi qendror i AKA: Ferdije Zhushi-Etemi dhe Basri Muja.

Fakulteti Eknomik i Universitetit te Prishtines ka aplikuar per akreditim institucional dhe akreditim te disa programeve te studimit. Raporti esht strukturuar ne kete menyre:

**Pjesa I** **Vleresimi institucional** [**Fakulteti i Ekonomise**]

**Pjesa II** **Vleresimi i programeve**

Pjese e vleresimit tone ishin programet ne vazhdim

| **Programi** | **Niveli/Tipi** | | |
|---|---|---|---|
| | **Bachelor** | **Master** | **Doktorature** |
| Ekonomiks | BSc | MSc | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Banka, Financa, Kontabilitet | BSc | MSc | ***Drejtimet:***<br>***Shkencat Eknomokike***<br>Ekonomiks<br>Banka, Financa, Kontabilitet;<br>Menaxhment dhe Informatike;<br>Marketing; |
| Kontabilitet | BSc | | |
| Nderrmarresi dhe Zhvillim Lokak | | MSc | |
| Menaxhment dhe Informatike | BSc | MSc | |
| Marketing | BSc | MSc | |

**Pjesa I Vleresimi institucional**

# 1. Deklarata e misionit

- **Vleresim i qellimeve dhe objektivave ne kerkim shkencor dhe mesimdhenie [deklarata e misionit]?**
- ***Vleresimi i potencialit per inovacion***
- ***A eshte deklarata e misionit e duhur ne raport me buri   et e disponueshme dhe eshte konunikuar ne menyre adekuate?***

Qellimi i pergjithshem i Fakultetit te Ekonomise pershkruhet si kontribues ne z   illimin e metejshem te Kosoves dhe ne shkencen e ekonomise, duke qene ne perputhje me misionin e universitetit. Kjo mund te jete vetem nje d klarate – fakulteti ankohet per shperndarje te ulet te burimeve (shih pjesen e meposhtme ne lidhje me lirine akademike). Deklarata e misionit eshte udhepershkrim cili ďuhet ’jetuar dhe duhet te shperbeje si pike-reference per synime afatgjate te stafit ne lidhje me villimin e fakultetit. Ne te kunderten nje deklarate vetem sa per pershkrim nuk eshte dobishme.

Vizioni i tyre ", per te arritur atje" – nje deklarate qe pershkruan gjendjen e deshiruar te institucionit eshte pak a shume e pergjithesuar, nuk e  hte specifike per fakultetin dhe e

njejta mund te ishte pershtatur edhe per institucione tjera. Raporti i vete-vleresimit ofron disa ide per te ardhemen [fq 9] – asgje me shume. Edhe keto nuk jane specifike per fakuletin. Ndoshta ka nje deshire per te qene me te pavarur.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Ideja e dezintegrimit institucional mund te jete kunder-produktive. Procesi i krijimit te universiteteve te integruara ne vendet e Ballkanit Per ndimor dhe pjeserisht edhe ne vendet e ish-Bashkimit Sovietik ka qene mjaft i veshtire. Sidoqofte, eshte me rendesi qe stafi universitar ta dojne dhe jetoje me te. Rekomand qe i tere procesit te jete transparent dhe i hapur ne menyre qe te dihen perfitimet e te qenurit nje institucion – natyrisht eshte e kuptueshme se disa fakultete kontrib ne me shume se sa te tjeret.
Mund te jete ide e mire krijimi i nje institucionit te pavarur per studime ekonomike ashtu sic mund te ekzistoj ne vendet tjera. Megjithate, se p eshte e nevojshme qe te kete pajtueshmeri ndermjet paleve te interesuara dhe te realizohet ne mirekuptim te perbashket. Disa fakultet mund te bartin me shume barre se tjerat. Por kjo mund te jete vetem ne afat-shkurter dhe afat-mesem. Ne afat-gjate duhet gjetur nje perspektive e balancuar e cilesise.

## 2. Liria Akademike

- ***A garanton institucioni qe statute i tij dhe struktura organizative lejojne lirin akademike ne kerkim shkencor dhe mesimdhenie?***

Fakulteti i Ekonomise qeveriset ne baze te Statutit te Universitetit te Prishtines –pjese e se cilit institucion eshte aktualisht. Fakulteti kryes het nga Dekani dhe dy pro-Dekane te cilet i pergjigjen Rektorit te Universitetit te Prishtines. Nuk eshte e qarte ne baze te pershkrime te ofruara nese ekziston ndonje trupe keshilledhenese apo senat qofte ne nivelin e fakultetit apo ate te Universitetit te Prishtines. Be fakt senati permendohet por nuk gjinden kund ne raportin e vete-vleresimit. Keshilli i Fakultetit perbehet nga tre [pr dekanet, Sekretari dhe perfaqesues te profesoreve, asistenteve, stafi jo-akademik dhe studentet. Stati i fakultetit qendron ne Keshill per tri vite radhazi ndersa studentet per nje vit. Per nga numri duket sikur profesoret e kane shumicen e nevojshme. Votimi nuk pershkruhet por supozojme qe profesoret nuk mund te mbi-votohen. Kjo eshte nje aspekt mjaft interesant kur kihet parasysh fakti qe profesoret jane te orientuar kah kerkimi shkencor [deqidiv per karieren e tyre] dhe mund te mos jene te interesuar ne fushat tjera te Keshillit te Fakultetit si supervizimi i mesimdhenies dhe propozimet per kurrikula te reja ne Senat.

Nje fushe tjeter ajo e ṕergatitjes se propozimeve per Dek n e Fakultetit ’nuk definohet dhe mund te jete gjithcka dhe asgje. Procesi i Bolonjes k ate beje edhe me mesimdhenie edhe me mesimnxenie –fakulteti mund ta kete te veshtire te reformohet rrejnjesisht per tu pershtatur me kerkesat e ketij procesi. Ndonse refo mimi sipas procesit mund te jete nje nga qellimet e stafit ne dyshojme nese mesimnxenia dhe studentet jane te perfaqesuar denjesisht ne Keshill [vetem dy perfaqesues studentesh].

Pervec sekretarit, edhe Koordinatori i ECTS-ve dhe Sherbimi Financiar i raportojne Dekanit –anipse kjo nuk eshte shume e qarte ne baze te pershkrimeve ne raport. Ata jane pjese e stafit ne mbeshtetje te Dekanit. Nuk eshte e qarte nese ka zyra apo staf tjeter qe punun ne kuader te dekanatit. Edhe sherbimet per studime bachelor dhe master dhe bibloteka qeverisen nga Dekanati por ata duket se oje te pavarur nga njeri-tjetri

dhe nuk eshte qarte cfare linjash komunikimi kane nder ehte. Puna e tyre perkrah kater departamente por termat e tyre te references nuk shpjegohen ne raport.

Ne baze te parimit te Universiteteve te integruar eshte e qarte qe fakultetet operojne ne kornizen e politikave te zhvillimit universitar. Shperndarja e burimeve financi e –gje qe ndikon ne zhvillimin e fakulteteve –varet nga strategjia e pergjithshme universitare e projektuar nga organet qeverisese te universitetit. Edhepse Dekani se bashku me nje profesor te fakultetit [ashtu sic pershkruhet decentralizimi ne SER], fakulteti ankohet per hise te vogel ne te shpenzime anipse ata gjenerojne sh te hyra. Ata duken te limituar ne lirine e tyre akademike dhe ne ndjekjen e qellimeve te tyre dhe jane te frustruar si rezultat. Kjo perkeqesohet sidomos nga fakti qe ata du et te pranojne shume studente. Sipas Bordit te Universitetit [nuk ka informacione sa perket anetareve te tij –apo mos ndoshta po flitet per Senatin] –proporcioni ndermjet studenteve dhe stafit ne ligjerata eshte 150:1 ndersa ne seminare 75:1. Kjo mund te jete vetem ajo qe pershkruhet ne leter.

### *Rekomandimet dhe Komentet*

*Paneli i eksperteve eshte shume i vetedijshem per ceshtjet dhe sfidat tipike te te gjitha universiteteve te integruara –kjo eshte forma me e zakonshme e organizimit ne Zonen Evropiane te Arsimit te Larte. Por duhet cekur se keto sisteme funksionojne me se mir kur shperndarja e resurseve behet ne menyre transparente, komunikohen dhe bazohen ne respect te ndersjellte ne mbeshtetje te strategjise se perbashket. Paneli i eksperteve nuk mund te vleresoje nese Universiteti i Prishtines e trajton Fakultetin e Ekonomise ne menyre te padrejte. Rekomandojme qe keto ceshtje te percillen tek Universiteti dhe sidomos Senati qe eshte trup vendimarres ne kuader te titucionit. Proporcioni staf-studentet duhet rishikuar ngase ngarkesa e teper behet teper demotivuese dhe pengon zhvillimin e nje klime te duhur akademike. Ndertimi i sallave me te medha te ligjerimit nuk eshte zgjedhje ne ditet e sotit kur kemi parasysh tin qe institucionet arsimore po ecin ne drejtim te dizajnimit te procesit dhe infrastruktures me qender studentin.*

## 2. Programet Akademike dhe Menaxhimi i studenteve

- ***A korrespondojne programet akademik me misionin e inst utcionit dhe parimet e punesimit?***
- ***A eshte cilesia, rangu dhe qellimet e kurrikules te duhuara per kualifikimet akademike?***

Meqe misioni eshte mjaft i pergjithshem, rrjedhimisht cdo program eshte kompatibil me te. Gjithashtu, programet e ofruara nga Fakulteti pers n me deklaraten e misionit ne lidhje me potencialin e te diplomuarve per zhvillimin te metutjeshem te rajonit. Te diplomuarit duken sa kane shansa te mira punesimi. Mirepo ashtu sic shprehet edhe vete institucioni, nuk ka informacione te nevojshme ne lidhje nderprerjen e studimeve, numrin e studenteve qe hyjne ne provime me shume se nje here. Fakulteti duhet te insistoj ne ndertimin e nje databaze ne menyre qe info acionet te bazohen ne informata e jo vetem ne opinion dhe pershtypje.

Programet duken ngushte te lidhura me ato ne Sloveni, oaci dhe Shtete te Bashkuara. Natyrisht eshte e nevojshme qe te referohen ne programe vendeve tjera si standarde dhe praktika te mira, mirepo eshte poashtu e nevojshme qe Fakulteti te kete profiling e tij te studimeve. Fakulteti eshte krenar per faktin qe programet e tij jane te ngjashme [ne masen 80%] me ato ne vendet tjera. Kjo ofron confidence dhe mbrojtje nga programe individuale dhe te specializuara te cilat do ti ofronte stafi akademik. Sidoqofte, ne nuk inkurajojme kopjimin ngase ambienti dhe konteksti ne keto vende mund te jete I ndryshem dhe ai ndryshon ne vazhdimesi. Fakulteti ka nevoje per nje profil te tij dhe kjo do ti ndihmone ne qendrueshmeri te vazhdueshme.

Ne gjithashtu dyshojme nese programet aktuale jane ́shkencore ’ [Science]. Duhet diskutuar dhe shqyrtuar ne nje qasje me te harmoniuar ne nivel te Kosoves dhe te vendoset ne baze te rezultateve te te mesuarit se cili kualifikim mund te jete me i pershtatshem [Arte apo Shkence].

***Rekomandimet dhe Komentet***

*Ne inkurajojme fakultetin qe mbrenda nje kohe te duhur te shikoj mundesine e zhvillimit te profilit te tij. Ndejkja e praktikave te mira dhe ndardeve duhet te ndiqet dhe reflektohet per se afermi. Duhet marre parasysh edhe ecifikat e Kosoves. Si fillim ne mendojme qe nje marredhenie e ngushte e programit me programe te praktikave te mira mund te jete e dobishme per tů mbrojtur nga tendencat e dizajnimit te programeve te ngushta, programet qe dominohen nga interesa te ngusht te stafit. Per tu arritur keto ndryshime Fakulteti ka nevoje urgjente per informacione te rregullta dhe te perditesuara. Kjo mund te fitohet nga puna e rregullet kerkimore-shkencordhe analizimi i tregut te punes, por mund te ofrohet edhe nga Universiteti dhe m ndjekje te te dhenave te studenteve, tregjet ku ata [nuk] depertojne pas studimeve etj. Gjithashtu, duhet te rishqyrtohet dhe analizohet nga afer emertimi i programeve dhe emertimi i kualifikimit Science 'apo Arts '[Shkence apo Arte 'ne menyre qe p e interesuara te jene ne gjendje te verejne dallimet. Ne pergjithesi ne baze te praktikes programet Banka, Financa, Kontabilitet,' Marketing 'dhe Nderrmarresi zhvillim lokal 'jane te tipit Arts ' [BA apo MA e jo Bsc apo Msc]. Programi Ekonomiks 'eshte i hapur per debate te ndryshme edhepse lloji i programit te ofruar nga Fakulteti duke te jete me teper i tipit Arts.'*

- ***A jane programet te bazuara ne nje koncept te unisuar idaktik dhe i cili eshte diskutuar dhe pranuar nga stafi mesimdhenes?***
- ***A korrespondojne programet me standarde nderkombetare?***

Fakulteti ka ndryshuar teresisht duke bere diferencimin Bachelor-Master-Doktorates, ne perputhje me qellimin e Deklarates se Bolonjes. Megjithate, duket sikur ndjek nje qasje shume strikte sa i perket numrit te viteve –3+2+3 eshte vetem nje qasje e mundshme krahas dis ate tjerave. Ne shume vende Evropiane praktikohen vite te ndryshme. Gjithashtu, Bolonja nuk parasheh ndonje Master Profesional.' Cfare niveli ne raport me Indikatoret e Dublinit parashihet per nje program te tille? Nderlidhja me rezultatet e te mesuarit duhet te ndiqet me per se afermi. Duke sikur ka nje qasje te unisuar e qasje didaktike ngaqe raporti duket te jete plotesuar ne gru Nje pyetje qe ne ende nuk patem tere informacionin eshte nese eshte perfshire i gjithe stafi ne kuptim te komunikimit permes involvimit te dyre ne diskutime, punetori etj.

Eshte permendur se fakulteti ka ndermend te ofrohet me teper me industrine dhe te rris shkallen e aplikativitetit te programeve te tij. Studentet e mirepresin nje ide te tille. Perafrimi me tregun e punes natyrisht duke mos harruar renedesine e mesime teorike do te ndihmone fakultetin ne permbushjen e objektivave te tij. Fakulteti eshte duke tentuar te jete me prane procesit te Bolonjes. Ata kane marre mesimet e mira nga universitete qe jane anetare te Zones Evropiane te Arsimit te Larte por edhe ten je institucioni jashte Evropes per ti bere programet e tyre ne pajtueshmeri me standardet nderkombetare. Fakulteti eshte poashtu i angazhuar aktivisht ne programet e Bashkimit Evropian, posacerisht TEMPUS ne kuader te se cilit marrin mesime nga universitete te ndryshme Evropiane dhe me gjere.

***Rekomandimet dhe Komentet***

*Mund te jete e dobishme te marrin ne konsiderate opsione te ndryshme ko ore per kompletimin e studimeve ne varesi te rezultateve te te mesuarit. Gjithashtu nuk eshte e udhes qe te mblidhen vitet ne kete forme 3+2+3. Perpos qe Bolonja lejon organizim te ndryshem kohor, nje mbledhje e tille sygjeron vazhdimesi te studimeve gje qe mund edhe te mos jete e vertete [disa mund ti nderpresin at qe ne ciklin e pare]. Pra, secili cikel eshte studim ne vehte edhe ndalimi i tyre apo vazhdimi mund te mos e ndjekin vetem kete ritem. Keshillojme qe grupi qe ka perpiluar kete raport duhet te jete ne kontakt dhe ti komunikoj keto me hisedaret e institucionit. Nje harte e partnereve dhe hisedareve te institucionit ndihmoje dhe japin indikac one ne cilet industri ka nevoje te ofrohet. Iniciativat per bashkepunim me institucionet Evropiane duhet te vazhdojne dhe stafi duhet te mbeshtetet te formuloj aplikacione per rograme mbeshtetese. Duhet themeluar nje infrastrukture te tille mbeshtetese. Kjo ndihmon ne peraferim te metutjeshem me standardet nderkombetare dhe te absorbo en ide te perditesuara ne lidhje me zhvillimet ne fushe.*

- ***A ofron struktura e programeve mundesi te mjaftueshme per studim te pavarur, reflektim dhe analize?***
- ***A eshte bere alokimi i ECTS kredive ne menyre te duhur?***
- ***A eshte ngarkesa e menaxhueshme per studentet?***

Duhet arritur nje ekuiliber te pershtateshem. Me perjashtim te gjashtemujorit te pare, studentet e programeve bachelor ne pergjithesi mund te zgjedhin 1 lende zgjedhore nga tre opcione ose me shume opsione.Vetem ne semestrin e gjashte –ne nivelin bachelor – lendet zgjedhore kane nga 4 kredi, ndersa ne semestrat tjere ato kane nga 6 kredi. Nuk eshte e aresyetuar se pse ka ndodhe kjo mirepo me sa duket eshte si rezultat i ‘qasjes matematike ’–pershtatja e kredive vetem per te arritur numrin e kredive 30. Ky rast nuk perseritet ne studimet master anipse lendet zgjedhore kane peshe e te vogel se lendet obligative.

Alokimi i ECTS-ve nuk eshte shpjeguar detajisht dhe mund te mos jene ne perputhje me Udhezuesin e ECTS te vitit 2009 anipse sipas fakulteti ata i respoktojne ato. Nuk eshte ne perputhje me ECTS-te nese kredite alokohen ne baze te rendesise ashti sic pershkruhet ne faqen 31 te SER [‘Te gjitha kurset dizajnohet ashtu qe te reflektojne rendesine e tyre ne kontekst te relevances kerkimore t programit dhe te arritjes se objektivave te programit’]. Flitet edhe per ‘ngarkesen ’por nuk jipen detaje per te. Studimet duken te jene te menaxhueshme per studentet. o, ne kemi dyshime se ekziston ndonje nderlidhshmeri ndermjet kredive, rezltateve te te mesuarit, ngarkeses dhe provimeve.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Fakulteti duhet te rishqyrtoje alokimin e kredive. Ne ikurajojme per me shume transparence kasrshi hisedareve te institucionit dhe posacerisht te studenteve –kredite jane te dizajnuar pikerisht per ta ne menyre qe ata te kene informacione te plota ne lidhje me kornizen kohore te permbushjes se obligimeve per te arritur rezultatet e te m suarit. Ne rekomandojme ridizajnim te kredive sipas udhezuesit te ECTS-ve. Mund te jete e udhes qe te alokohet nje numer i caktuar i kredive dhe te kerkohet nga stafi qe te formuloj ngarkesen e parapare per to ne perputhje me rrethanat. Sidoqofte, ngark e punes se studenteve duhet te vleresohet rregullisht me masa adekuate ne menyre qe te kuptohet nese studentet jane ne gjendje per ti permbus

Nuk eshte e udhes qe alokimi i kredive te behet vetem per te matur progresin e studenteve ne nje program te caktuar. Kredite vetem re lektojne ngarkesen e punes dhe

nuk duhet te keqperdoren as per perzgjedhje, as per peshim te notes e as si forme qe mat progresin e studentit ne absorbimin e njohurise: kredite vetem reflektojne arritjen e sukseseshme te rezultateve te te mesuarit.

***A jane metodat mesimore dhe permbajtja e njesive mesim re te mjaftueshme per arritjen e suksesshem te qellimeve dhe rezultateve (kompetenca dhe kualifikimet, njohurite dhe shkathtesite) te programit? A jane rregullat e provimeve te pershtatshme? •A eshte nderveprimi i permbajtjes akademike ndermjet kurrikul e te ndryshme e kuptueshme dhe transparente?***

Kjo eshte pershkruar ne detaje ne programe te ndryshme te pershkruara me poshte. Sigurisht, mikro-mjedisi, dmth infrastruktura dhe numri i studenteve duhet te merren parasysh. Sic u theksua me pare, proporcioni aktual eshte i padobishem kur kihet parasysh ndryshimet ne paradigmen e edukimit – nga studimi kur profesori ishte ne qender ne studim ku studenti eshte ne qender. Sipas ECTS-ve dhe kesaj qasje te re te edukimit nuk eshte e dobishme te kemi vetem nje format te provimeve por testimi duhet te organizohet ne ate menyre qe mat arritjen e objekti ave te mesimit. Nese testimi me goje do te ndihmonte ne vleresimin e arritjes se objektivave atehere nuk do te duhej te kishte nevoje per provim me shkrim. Raporti ofron pershkrim te permbajtjes se kurseve dhe ato duken te jene bukur te nderthurura ne kuader te programit.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Te gjitha qasjet bashkekohore ne mesimdhenie jane te dobishme. Duke marre parasysh numrin e madh te studenteve dhe numrin e ulet te stafit mesimdhenes, nje mesim i perzier mund te jete me i dobishem si per mesimdhenie htu edhe per mesimnxenie dhe kerkim shkencor. Studentet do te ishin te lumtur me aplikueshmerine e propozuar te programeve. Llojet e provimit duhet te jene adekuate n ate menyre qe te informojne arritjen e nje objektivi te caktuar ne mesimdhenies pe cilin fitohet nje numer i caktuar i provimeve. Seminaret e trajnimit mund te ndihmojne stafin per tů informuar ne lidhe me opcionet e mundeshme [megjithe numrin e larte te stude teve]. Studentet do te ishin mirenjohes per zbatimin e modeleve ne realitet – kur eshte e pershtatshme. Llojet e provimeve duhet zhvilluar edhe me tutje.

.

- ***Si qendrojne kriteret dhe proceset e pranimit ne krahasim me standardet nderkombetare?***
- ***A eshte proporcioni staf/student i duhur?***

Fakulteti ka per te aplikuar rregullat kombetare per rekrutimin e studenteve. Ata do te preferonin te jene ne gjendje te jene me selektiv. Kerkesat e pranimit per studentet e huaj dallojne nga ato te studenteve lokal. Studentet e huaj nuk mund te ofrojne certifikata te lenies se shkolles paraprake p.sh. gje qe eshte e rendesishme per te ofruar numrin e pikeve ashtu sick parasheh ministria dhe per te lejuar nje student per te filluar mesimin ne nje institucion te caktuar. Shqetesimi me i madh i fakultetit eshte proporcioni staf-student. Ata kane bere perpjekje dhe kerkese te vazhdueshme per rritje te numrit te stafit por nuk kane qene te sukseseshem ne menyre adekuate.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Eshte thelbesore qe gjithashtu rekrutimi te jete –element i autonomies se nje fakulteti. Per aq kohe sa nje fakultet nuk mund te emeroje nje numer te duhur te stafit mesimdhenes ne proporcion me numrin e studenteve, cilesia e arsimit vuan. Fakulteti do te vazhdoj te insistoj ne numer me te madh dhe cilesi me te larte te mesimdhenesve por duhet shikuar edhe mundesite e diteve te sotit qe ne mesimdhenie u referohen si 'mesim i perzier '[iniciativat ne kete drejtim kane filluar].

## 4. Kerkimi shkencor

- ***Cilat jane pritjet per kerkim shkencore te institutcio it dhe si nderlidhen kjo me numrin dhe cilesine e stafit te perhershem?***
- ***A eshte i involvuar stafi ne aktivitete te kerkimit sh encor mbrenda dhe jashte vendit dhe a reflektohet kjo ne permbajtjen e kurseve?***

- ***A kemi involvim te studenteve ne kerkim shkencor mbren a apo jashte institucionit dhe a reflektohen keto aktivitete ne permbajtjen e kurseve?***

Nje perzgjedhje e punes kerkimore eshte shenuar ne SER. Ne pershkrimet individuale te programeve ne do ti referohemi kesaj ceshtje me shu Lista e ofruar nuk shfaq nivelin e cilesise se ketyre iniciativave, as rezultatet as nderlidhshmerine me strategjine e institucionit apo universitetit. Nje Qender per Kerkim shkencore do te ndihmone ne permiresimin e nje qasje te perbashket per zhvillimin e nje sistemi me transparent.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Te gjitha palet qe ne takuam gjate vizites ne terren shprehen deshiren e tyre per krijimin e nje qendre kerkimore shkencor qe eshte diskutuar per nje kohe te gjate. Ekspertet jane te mendimit qe institucioni do te perfitonte shum ete drejtim. Nje qender e tille jo vetem qe do te ishte hap i udhes, por me e rendesishme eshte qe kjo te jete funksionale dhe e qendrushme. Gjate diskutimeve eksper et paten pershtypjen qe kerkimi shkencor eshte rezultat i iniciativave individ ale. Per kete aresye themelimi i nje qendre te tille do te inkurajonte stafin qe te fokusohet ne kerkim shkencor qe mbeshtet institucionin.

.

## 5. Bashkepunimi nderkombetar

- ***A eshte niveli dhe cilesia e bashkepunimit nderkombeta per hulumtim dhe mesimdhenie adekuate?***
- ***A jane strategjite e nderkombetarizimit dhe involvimit te stafit dhe studenteve ne bashkepunime trajnuese e programe mobiliteti adekuate?***

Fakulteti ka shume partnere nderkombetare dhe duket te jete pranuar plotesisht brenda rrjeteve nderkombetare edhe ne kuader te projekteve evropiane. Nje bashkepunim i qendrueshem megjithate do te arrihej vetem atehere kur dy partneret e involvuar do te perfitonin nga kjo marredhenie. Duhet te kete nje strategji te qarte te nderkombtarizimit. Mobiliteti i studenteve nuk eshte zhvilluar per shkak e problemeve ligjore. Studentet me

te vertete duan qe te kene mundesine per levizje dhe te jene ne kontakt me student tjere, stafin, institucionet, kompanite dhe vendet.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Partneriteti duhet te kete mbeshtetje strategjike. Nje partneriteti duhet te ndihet ne te gjitha nivelet, stafin dhe studentet. Ekuilibri i levizshmerise nuk mund te arritet gjithmone. Mirepo ka mundesi tjera bashkepunimi: shkembim stafi, ashkepunim ne mesimdhenie, shkembim videosh, raste studimit etj ne menyre qe partneriteti te jete ne suaza te barabarta. Partneret duhet te perzgjedhen ne menyre strategjike sa i perket tipit, kerkimit shkencor, mesimdhenies and lokacionit gjeografik. Nens rimi i memorandumeve te bashkepunimit eshte gjeja me e lehte. Niveli i nderkombetarizimit nuk matet me keto marreveshje te nenshkruara. Programet e studimit mund e pasurohen sikur te kete 'dritare mobiliteti.' Ato do te lejonin dhe krijinin m desine per levizjen e studenteve ne kohen me te pershtatshme ne nje vend tjeter apo ne vend per arsye te ndonje stazhi, studimi semestral apo pune qe do te komplementonin stu . Zhvillimi i programeve te perbashketa me institucionet tjera do te ishte nje undesi e mire poashtu. Nje mundesi ne kete drejtim jane praktikat e binjakezimit te qyteteve.

## 6. Stafi

- ***A ka institucioni proporcion te mjaftueshem te stafit ermanent dhe proporcione te duhura te stafit permanent dhe te jashtem?***
- ***A demonstron stafi aktual nivel te larte akademik dhe idaktik dhe a jane kualifikimet e tyre te duhurs per pozicionet qe ata kane mbrenda institucioni?***
- ***A ka barazi gjinore tek stafi?***
- ***A ka institucioni rregulla per perzgjedhje te stafit q jane trnasparente, garuese dhe te drejtuara nga cilesia?***
- ***A ka institutcioni strategji zhvillimi ne menyre qe te sigurohet qe stafi aktual miremban standardet e larta ne menyre te vazhdueshme?***

Fakulteti eshte i vetedijshem per nevojen e shtimit te numrit te stafit. Kjo eshte cekur me lart disa here. Nuk ka asnje dyshim ne lidhje me cilesine e personelit - pyetja eshte se a ka staf te mjaftueshem ne nivelin e duhur per tu perballuar me numrin e larte te studenteve dhe arritjen e standardeve nderkombetare. Studentet tregua se ishte

problem gjetja e mentoreve per tezat e tyre te diplomes. Ekspertet nuk ishin ne gjendje te identifikojne neser kishte balance te duhur mes meshkujve dhe femrave ne kuader te stafit akademik.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Ne inkurajojme Fakultetin per te motivuar stafin per te vene ne veprim perpjekjet e tyre te plota ne zhvillimin e fakultetit. Kjo i referohet si mesimdhenies ashtu edhe kerkimit shkencor. Mirepo stafi kerkon mbeshtetje ne kete drejt Kompensimi adekuat financiar eshte vetem nje aspekt. Mjedisi i punes eshte thelbesor. Kontratat duhet te respektojne ne menyre adekuate ngarkesen e punes dhe ne vecanti me cilesine e ofruar. Duket mjaft e lehte te te gjendet staf i jashtem per lende te specializuara [duke qene ne Prishtine].

me cilesi te pritet ne menyre qe fakulteti i merr ne v anti stafit me kohe te plote. Kjo duket te jete relativisht e lehte - te qenit ne Prishtine - per te marre te stafit te jashtem per tema te specializuara. Menyrat dhe mjetet duhet te diskutohet per te permiresuar situaten per studentet, duke qene ne nevoje per mbikeq resit / mentoreve ne punen e tyre akademike. Duhet diskutuar dhe gjendur mundesi per te adresuar an ne lidhje me veshtiresite e studenteve per mentor qe mbikqyrin p en e studenteve.

# 7. Organizimi, menaxhimi, planifikimi

- ***A ka institucioni struktura transparente te vendimarrj per qeverisje, menaxhment dhe ceshtje administrative?***
- ***A ka institucioni struktura transparent te vendimarrje per ceshtje akademike?***
- ***A ka strategji zhvillimi dhe si komunikohet ajo nga mb enda?***
- ***Sa korrespondon strategjia e zhvillimit me qellimet e pergjithshme te institucionit dhe planin financiar ?***

***Rekomandimet dhe komentet***

Keto ceshtje jane diskutuar ne kuader te seksionit te irise akademike. Ne vetem mund te perforcojme ato qe cekem ne ate seksion duke kerkuar q institucioni te kete nje strategji

zhvillimi per te ardhmen. Fakulteti duhet te jete me transparent ne punen e tij. Raporti i vete-vleresimit nuk ofron informacione te duhura ne kete aspekt.

## 8. Financat dhe infrastruktura

- ***A ka institucioni nje buxhet adekuat dhe burime te mja ueshme financiare ?***
- ***A ka institucioni ndertesa te mjaftueshme dhe infrastr cture te specializuar ne lidhje me kerkesat e programit akademik dhe kerkimit s kencor [bibloteka, kompjuteret, laboratoret]?***

***Rekomandimet dhe komentet***

Sic e cekem me heret ne kete raport fakulteti eshte ankuar per buxhet te vogel ne krahasim me te hyrat qe kontribojne ata per universitetin. Duhet me shume transparence dhe diskutime te hapura per te tejkaluar kete frustrim. Infrastruktura e pergjithshme eshte ne rregull por nuk duhet harruar qe studentet kane nevoje per me shume hapesira pune individuale dhe grupore. Edhe bibloteka ka nevoje per permiresim. Universitet mund te bashkepunojne ne drejtim te themelimit ten je biblotek te perbashket sidomos ato ne Prishtine. Edhe kompanite mund te ndihmojne ne kete drejtim. Edhe kolegjet partnere mund te ndihmojne ne dhurimin e librave – te cilat jo domosdoshmerisht mund te jene edicionet e fundit. Per me teper fakulteti duhet te pe jeket per te shfrytezuar me mire burimet elektronike si Science Direct ’apo Athens .’

## 9. Menaxhimi i cilesise

- ***A ka institucioni sistem per sigurim te cilesise ne me imdhenie, kerkim shkencor dhe sherbime?***

- ***Cilat metoda te komunikimit, sbatimit dhe dokumentimin perdoren nga sistemi i sigurimit te cilesise?***

- ***A ben institucioni vete-vleresime te vazhdueshme?***

- ***A vihen ne veprim rezultatet e evaluimit dhe inkorporo en ne plan te zhvillimit?***

Zyra e Sigurimit te Cilesise – si pjese e Zyres per Zhvillim Akademik – eshte themeluar per te hartuar nje sistem te mire te cilesise ne nivel universitar. Universiteti ka percaktuar "Udhezimet per Sigurimin e Cilesise te Universitetit te Prishtines", dhe ofrohen detaje edhe cfare ndodh edhe ne fakultetin e arteve - por nuk ka detaje te metejshme ne lidhje me te. Pervec kesaj listohen edhe mekanizma tjere. Mirepo duket se kemi nje m ese koherence ne nivel te fakulteti. Aktivitetet individuale duhet te nderlidhen ne nje sistem te strukturuar. Zyra e sigurimit te cilesise apo ky funksion duhet te operoj ne menyre te pavarur – sikur nje lloj mini Agjencie Kosovare e Akreditimit ne nivel fakulteti. Nga informacionet e ofruara ne gjykojme se kjo nuk ndodh n ader te fakultetit.

***Rekomandimet dhe Komentet***

Do te ishte e udhes te diskutohet nje menyre qe inicia ivat individuale te zhvillohen ne kuader te nje sistemi te mbrendshem te sigurimit te ci . Per momentin veprimet e pershkruara nuk jane mire te integruara. Mungesa e te dhenave te studenteve eshte nje shkak esencial pse operimi eshte i veshtire.

# 10 Konkluzionet

Fakulteti Ekonomik i Universitetit te Prishtines duhet akredituar si institucion. Mirepo, pengese e rende eshte numri i ulet i profesoreve me norme te plote, profesoreve te asociuar dhe personelit tjeter mesimdhenes ne raport me numrin e studenteve ne tri nivelet e studimit [Bachelor, Master, Doktorature] dhe krahasuar me Kornizen e Kualifikimeve te Arsimit te Lartet e Bolonjes. Universiteti duhet te rishikoj kete ceshtje shume seriozisht ne menyre qe te mos rrezikohet cilesia e programeve te studimit. Ne te kunderten duhet te zvoglohet numri i studenteve.

Per te mbeshtetur cilesine e fakultetit dhe qendrueshmerine e tij eshte thelbesore per te rritur nivelin e punes se organziaur kerkimore. Mund te jete shume e dobishme per te perfshire studentet bachelor dhe Master. Studentet mirepresim nje mundesi te tille. Nje rritje e volumit dhe cilesise se kerkimit shkencor do te rriste mundesite e teksteve botuese, libra, gazeta dhe artikujve vendor dhe jashte vendit. Nje qender kerkimore do

te lehtesoje keto zhvillime te cilat do te mbeshteten duke i ofruar stafit me shume shanse per te marre pjese ne konferenca, simpoziume. Per te mbeshtetur stafin dhe studentet duhet bere investime te medha ne infrastrukture, ne vecanti objektet mesimore (dhoma te vogla, me nivel te mjaftueshem te librave ne aspektin e cilesise dhe sasise biblioteke, shfrytezimi i burimeve online)

Fakulteti mund te marre parasysh me teper rekomandimet e pershkruara me lart ne nen-seksionet individuale te ofruara me larte. Nje diskutim i plote i tyre mund te ndihmoje ne zhvillimin e metejshem te fakultetit dhe per te arritur nje nivel me te larte te qendrueshemerise.

# Part II Vleresimi i programeve

Programet ne ekonomiks

- § Bachelor
- § Master

Programmet ne Banka, Financa dhe Kontabilitet

- Bachelor
- Master

Programi ne Nderrmarresi dhe Zhvillim Lokal

- Master

Programet ne Menaxhment dhe Informatike / Marketing

- Bachelor
- Master

Programet ne Shkenca Ekonomike

- PhD

Konkluzionet

# Ekonomiksi

## Bachelor

### 1. Mission

Fakulteti Ekonimik organizon studimin ne Ekonomis 'ne perputhje me misionin e tij edukativ, qellimet dhe problemet ashtu sic jane definuar ne raportin e vete-vleresimit [fq 8]. Misioni programor eshte i qarte dhe i sinqerte ne dhje me problemet socio-ekonomike qe ka Kosova dhe nevojat per specialite me mjeshteri te larta ne sferen e ekonomise: bashkepunim ndermjet industries, firmave d shtetit [fq 33]. Ky program influencon politiken kombetare. Fakulteti i Ekonomise he Departamenti i Ekonomise eshte duke ndihmuar ne zgjedhjen e problemeve shoqerore shpejt dhe ne nderlidhshmeri me standardet evropiane.

Ky program studimor ne Ekonomiks 'dhe misioni i tij jane konsistente me 2 Universitete – anetare te procesit te Bolonjes – Universiteti i Lublanes dhe i Zagrebut. Ai poashtu pjesrisht ne masen 31% konsiston me programin e studimit ne Arizone. Ky pr gram e ka per mission pergatitjen e mjeshterive te studenteve per tregun e punes dhe te jene garues si specialist ne vendin e tyre.

### 2. Studentet

Fakulteti ka procedura per zhvillimin, permiresimin, vezhgimin dhe ripertritjen e dokumenteve arsimore [karakteristikat e kualifikimit, urrikulen dhe sillabuset] e ketij programi studimore ne Ekonomiks '–bachelor.

Perpara regjistrimit ne kete program studimi studentet informohen ne lidhje me te gjitha kerkesat e Fakultetit. Ata hyjne ne provim pranues. Si qofte programi duhet te informoj studentet ne lidhje me te gjitha lendet e programit st imor para se ata te regjistrohen. Studentet duhet te kene njohuri qe i lejon at ate punojne ne te gjitha fushat ekonomike dhe ate qe ata mund te bejne pas perfundimit te studimeve .'

Numri i studenteve te trajnuar ne kete program studimi shfaqet ne Tabelen 1:

Table 1. Teaching students for study program **'Economocs' in** bachelor degree

| Bachelor me te gjitha specializimet | Numri i sutdenteve full-time | Numri i studenteve part-time | Total |
|---|---|---|---|
| | 721 | 133 | 854 |

Te dhenat tregojne se kemi te bejme me nje numer te madh te studenteve.

Kurrikula permban metodologjine e studimit dhe metodat e vleresimit. Secila lende ka nje vlere te caktuar ne kuader te kualifikimit. Studentet n studimet bachelor duhet te akumulojne 180 kredi ose minimum 30 per semester. Kemi gjashte semester per kete program studimi. Nje kredi korrespondon me 25 ore ngarkese pune dhe perfshin totalin e leximit, punes ne shtepi, shkrimit, detyrave, ligjeratave d rovimeve .'

3. **Programi Akademik**

Programi ne Ekonomiks perfshin 19 lende obligative dhe 19 lende zgjedhore. Nga lendet zgjedhore studentet zgjedhin nje ne semestrin e dyte, lende ne semestrat 3,4,5 dhe prap nje lende ne semestrin e gjashte. Ne fund te prog mit studentet duhet te hyjne ne 27 provime lendesh per te kompletuar diplomimin. Propo ioni ndermjet lendeve zgjedhore dhe atyre obligative eshte: 8: 19=1:23,75. Ky rezultat eshte i mire por ne rekomandojme qe te kontrollohet permbajtja e disa lend Psh. Lenda e Matematikes dhe Matematikes Financiare dhe permbajtja e saj jane t thejshta dhe i gjasojne matematikes se shkolles se mesme. Ne rekomandojme qe p rmbajtja e saj te ndryshohet ndersa per ata me nivel me te ulet te organizohen lende plotesuese. Metodat e mesimdhenies dhe permbajtja e lendeve jane te mjaftueshme per arritjen e qellimeve dhe rezultateve. ECTS per secilen lende ne kuader te p ogramit akademik jane te duhura dhe te kuptueshme.

Mesimdhenesit e lendeve kane autonomine e perzgjedhjes rmbajtjes dhe perberjen e lendes gjegjese dhe metodat e mesimdhenies sipas profilit te Ekonomiksit.' Mesimedhensit kane te drejte te ndryshojne kurrikulen er secilin vit akademik ne menyre qe te jene ne pajtueshmeri me kerkesat e ekonomise Kosovare dhe nderkombetare. Strategjia didaktike formulohen ne baze te nderlidhjes me industrine aty ku studentet pritet te realizojne punen praktike. Mesimdhenesit ne kete program studimi zhvillojne metodologji speciale ne varesi te kapacitetit te studente e per te komunikuar me profesoret dhe stafin ne nderrmarrje.

Sipas nesh programi akademik korrespondon me deklaraten e misionit te fakultetit dhe parimet e punesimit. Kualiteti, rangu dhe qellimet akademik te kurrikules jane te duhura per kete kualifikim akademik.

## 4. Stafi Akademik

Stafi akademik i anagahuar ne mesimdhenie jane si vijo 19 anetare [3 profesore te rregullt, 2 profesore te asociuar, 10 asistent profeso 3 asistente dhe 1 asistent i ri]. Relacioni ndermjet te gjithe studenteve dhe numrit te t eshte 1:45. Mirepo proporcioni i studenteve krahas stafit me orar te plote eshte 1: 65,7. Numri i profesoreve, profesoreve te asociuar dhe profesoreve asistent eshte 1: 46,83. Keto te dhena shenjojne kah nje nevoje urgjente e rritjes se numrit te stafit.

Edhe stafi akademik part-time anagazhohet ne mesimdhenie. Numri I tyre eshte 15 [8 profesor doktore shkence, 3 Ligjerues, 4 Asistent]. R orti ndermjet profesoreve dhe stafit tjeter akademik eshte 11:22 = 1:2 dhe proporcioni ndermjet stafit akademik dhe studenteve eshte 854:33 = 25,88 : 1. Keto rezultate tregojne qe n mri i studenteve per 1 staf akademik eshte i madh. Ne rekomandojme qe te rrit numri i stafit te Departamentit te Ekonomiksit 'nese deshirohet te rritet cilesia e mesimdhenies.

Proporcioni i profesoreve te asociuar me Profesoret As ant eshte 1:5. Procedura per perzgjedhjen e tere stafit akademik eshte transparente dhe orientohet drejt kualifikimeve me te medha dhe gares.

Ne kuptuam se Fakukteti i Ekonomise dhe Departsamenti Ekonomiksit 'deshirojne qe te jene te krahasueshme me shkollat e arsimit te larte ne Evrope. Per arritjen e ketij qellimi shume nga mesimdhenesit kane perfunduar studimet ne vende te ndryshme Evropiane [Ljublane, Zagreb] dhe SHBA [Arizone] etj. Sh e nga ta kane marre kualifikimet ne disa nga keto vende. Shumica e profeso [80%] kane vizituar Universitetin e Staffordshire, Britani e Madhe, Vaxjo edi, Vrie University ne Belgjike, Universiteti i Amsterdamit, Holande, Universiteti i Bambergut, Gj rmani, Universiteti i Lublanes, Sloveni, Universiteti i Alcona, Universiteti i Alicante dhe Universiteti i Girones, Spanje etj. Qellimi i ketyre specializimeve te shkurtera eshte qe te rritet mundesia dhe kapacitet i mesimdhenesve ne rritjen e permiresimin e metodologjise se mesimdhenies.

## 5. Burimet materiale

Fakulteti dhe programi ne Ekonomiks kane salla te mjaftueshme, shume hapesire dhe pajisje te mira .psh. kompjutere dhe bibloteke per studentet [nese kjo do te ishte ne dispozion vetem te ketij programi]. Propozimi yne eshte qe per vitetet ne vazhdim fakulteti te blej me shume libra, raporte, studime etj dhe ti vere ato ne dispozion te studenteve. Kjo hapesire perdoret per te gjithe studentet e programit.

Hapesira e mesimdhenies per te gjithe studentet e prog amit eshte 3123 metra katrore dhe hapesira e disponueshme per nje person eshte 0,3123. Analiza e te dhenave tregon qe kjo hapesire nuk eshte e mjaftueshme. Hapesira dhe rmati ekzistues nuk lejojne ne zbatimin e te gjitha proceseve mesimore dhe aktiviteteve shkencore.

Stafi akademik nga Departamenti i Ekonomiksit perdor p sjet te ndryshme ne proceset e tyre arsimore. Numri i kompjutereve eshte i mjaftues em, por numri i studenteve eshte teper i madh dhe ky mbetet nje problem i madh per studentet dhe mesimdhenesit.

Ne mendojme qe numri i kompjutereve, projektoreve dhe e tjera eshte i majftueshme por rekomandimi yne kryesor eshte qe te pe miresohet hapesira per pune grupore gje qe do te permiresonte procesin akademil.

## 6. Studimet kerkimore shkencore

Sipas raportit te vet-vleresimit pothuajse te gjithe profesoret qe angazhohe ne mesimdhenie ne programin Ekonomiks ' marrin pjese ne s udime shkencore. Stafi akademik formulon problemtatikat te cilat jane te nderlidhura drejteperdrejte me problematikat e sferes ekonomike ne Kosove. Keto projekte jane shume te rendesishme per ekonomine e Kosoves. Gjate periudhes 2009-2011, stafi akademik nga departamenti i Ekonomiksit kane marre pjese ne 8 konferenca nderkombetare dhe ne nje conference kombetare [Aneksi 1 -fq 2-7]. Keto raporte jane publikuar ne revista shkencore nderkombetare. Si rezultat i punes se tyre ata kane publikuar artikuj, pergatitur raporte etj.

Por studentet e programit te Ekonomiksit te programit bachelor nuk kane patur mundesi te kontribojne ne projekte te kerkimit shkencor. Ne rekomandojme qe te perfshihen studentet ne keto projekte, sepse ne kete menyre stude tet jane ne gjendje te perfitojne pervoje dhe njohuri. Keto hulumtime duhet te jene te lidhura me ekonomine e Kosoves. Kerkuesit shkencor te rinj duhet te kene rezultate te a arsimore per tu angazhuar ne pune kerkimore shkencore. Studentet mund te publikojne hulumtimet e tyre ne nje reviste shkencore mbrenda dhe jashte vendit si stimul ne kete drejtim.

Publikimet shkencore nderkombetare ne leter jane bere sisht nga profesoret me norme te plote. Proporcioni i pjesemarrjes se profesor e ne konferenca per nje profesor eshte 8:15. Publikimet shkencore mbrenda vendit per nje staf akademik jane 1:8.

**Keto te dhena manifestojen qe publikimet mbrenda dhe ashte vendit jane te vogla. Ne rekomandojme qe te permiresohen indikatoret ne te ardh en dhe te involvohen studentet ne kerkim shkencor. Menaxhmenti i shkolles po ben perpjekje qe studentet te publikojne hulumtimet e tyre, qe studentet te marrin p ese ne konferenca.**

## 7. Vleresimi i njohurise se studenteve

Sistemi i vleresimit te njohurise se studenteve rregullohet ne nivel Universitar dhe perfshin evaluime te seciles pune te bere nga studentet gjate semestit. Shuma e alokuar

nga puna ne secilin seksion perben noten perfundimtare e cila pershkruhet ne sillabusin e seciles lende. Per lendet me orientim te thelle teorik, struktura e ekzaminimit eshte si vijon: pjesemarrja 10%, puna seminarike -15%, testi i ndermjeme – 20%, provimi perfundimtar –55%. Ne lendet me orientim me praktik dhe te cilat ja te drejtuara ka arritja e mjeshtrive te caktuara eshte si ne vijim: pjesemarrja 15%, puna seminarike – 15%, performance ne ushtrime 15%, praktika 15%, provimi perfundimtar 40%. Menyra e perpilimit te notes perfundimtare eshte precise ne kuptim qe studentet kane mundesi dhe pjese te ndryshme te testit dhe jo vetem nje provim pe fundimtar. Nese studentet fitojne 40% te pikeve gjate semestrit, kjo shume do te ruhet per secilin provim ne te ardhmen.

Proporcioni ndermjet pikeve te fituara ne total dhe pr vimit perfundimtat poashtu rregullohet ne baze te Rregullores se studimit ne nivel institucioni. Ne konsiderojme qe rregullat e provimeve jane te duhura.

Studentet duhet te pergatisin temen e Diplomes ne fund te studimeve Bachelor.

**Studimet Master**

**1. Misioni**

Fakulteti ka pergatitur programin Master ne Ekonomiks e menyre qe te zbatoj misionin, qellimet dhe problematikat e trajtuara ashtu sic definohen ne raport te vete-vleresimit [fq 8]. Misioni eshte i qarte dhe i sinqerte sa i perket blemve me te cilat ballafaqohet ekonomia kosovare dhe nevojes per specialiste te mire e fushes dhe ófrimi i tyre me industry, firma dhe shtetin.' Misioni eshte qe te krijohen specialist te tille te cilet mund te punojne vetem apo te marrin vende ne kushte risku dhe urie dhe te progresojne drejt studimeve te doktoratures. Ky program studimi p rcakton politikat ekonomike ni nivel shteti. Universiteti e ka arritur nje gje te tille. Fakulteti i Ekonomise eshte duke punuar me hapa te shpejte ne adresimin e ketyre kerkesave ne menyre te sshpejte dhe ne perputhje me standardet Evropiane.

Programi i studimit ne Ekonomiks dhe misioni i tij jane konsistent me 2 Universitete – anetare te procesit te Bolonjes si Universiteti i Lubl es dhe ai i Zagrebit. Ai poashtu koincidon me programin e studimit ne Arizone ne masen 2,31 %. Ky program studimi ka mission te pergatis studentet dhe mjeshterite e tyre per tregun e punes dhe te jene garues ne raport me speecialistet tjere mbrenda vendit.

3. **Studentet**

**Fakuleti organizon procedure per zhvillimin, permiresi in, vezhgimin, dhe ripertritjen e dokumenteve arsimore [karakteristikave te kualifikimeve, kurrikules dhe sillabuseve] te ketij programi.**

Perpara regjistrimit ne kete program studimi studentet informohen ne lidhje me te gjitha kerkesat e Fakultetit. Ata hyjne ne provim pranues. Si qofte programi duhet te informoj studentet ne lidhje me te gjitha lendet e programit studimor para se ata te regjistrohen. Studentet duhet te kene njohuri qe i lejon at ate punojne ne te gjitha fushat ekonomike dhe ate ́qe ata mund te bejne pas perfundimit te studimeve.' Numri i studenteve per nje program studimi eshte 80.

Kurrikula permban metodologjine e mesimdhenies dhe met   at e vleresimit. Studentet e programit master duhet te akumulojne 120 kredi apo minimum 30 kredi per semester. Kemi 4 semestera per arritjen e kualifikimit. Nje kred  korrespondon me 15 ore ngarkese pune e cila perfshin tere ngarkesen qofte ne lexim, pune shtepie, shkrim, ndjekje te ligjeratave dhe provimeve dhe pergatitja dhe mbrojtja            master.

## 3. Programi akademik

Programi studimor master ne Ekonomiks 'perfshin 10 lende obligative dhe gjashte lende zgjedhore. Studentet zgjedhin nga nje lende opcionale  e secilin semester. Ne perfundim te programit studentet duhet te kalojne 13 lende dhe te pergatisin temen e diplomes. Proporcioni ndermjet lendeve opcionale dhe obligative eshte 3:10. Ky rezultat eshte i mire por ne rekomandojme qe te kontrollohen le         Disa lende opcionale si Makroekonomia, Tregjet financiare dhe Politika Ekonomike te Bashkimit Evropian duhet te jene obligative. Metodologjia e kerkimit shkencor duhet te perfshihet ne semestrin e trete e keshtu me radhe.

Stafi akademik duhet te kontrolloj permbajtjen e lendeve. Psh. Metodat e matematikes se aplikuar, analiza statistikore dhe ekonometria 'kane permbajtje te shkolles se mesme dhe nuk jane te duhura per nje program master. Ne rekomandojme qe te rishikohet permbajtja e ketyre lendeve. Metodat e mesimedhenies dhe permbajtja e lendeve te tjera jane te duhura dhe ne perputhje me qellimet dhe rezultatet e te mesuarit.

ECTS per secilen lende jane mire te alokuara dhe jane te kuptueshme.

Mesimdhenesit e lendeve kane autonomine e perzgjedhjes        rmbajtjes dhe perberjen e lendes gjegjese dhe metodat e mesimdhenies sipas profilit te Ekonomiksit.' Mesimedhensit kane te drejte te ndryshojne kurrikulen  er secilin vit akademik ne menyre qe te jene ne pajtueshmeri me kerkesat e ekonom    Kosovare dhe nderkombetare. Strategjia didaktike formulohen ne baze te nderlidhjes me industrine aty ku studentet pritet te realizojne punen praktike. Mesimdhenesit ne kete program studimi zhvillojne metodologji speciale ne varesi te kapacitet  te studenteve per te komunikuar me profesoret dhe stafin ne nderrmarrje.

Sipas nesh programi akademik korrespondon me deklaraten e misionit te fakultetit dhe parimet e punesimit. Kualiteti, rangu dhe qellimet akademik te kurrikules jane te duhura per kete kualifikim akademik.

.

### 4. Stafi Akademik

Stafi i angazhuar ne mesimdhenie ne kete program eshte 15. Proporcioni ndermjet numrit te studenteve dhe numrit te stafit akademik eshte 80:15 =5, 33: 1 apo per cdo 5 studente kemi nje staf akademik. Ky eshte nje proporcion i duhur.

Ne kuptuam se Fakukteti i Ekonomise dhe Departamenti i Ekonomiksit 'deshirojne qe te jene te krahasueshme me shkollat e arsimit te larte ne Evrope. Per arritjen e ketij qellimi shume nga mesimdhenesit kane perfunduar studimet ne vende te ndryshme Evropiane [Ljublane, Zagreb] dhe SHBA [Arizone] etj. Shume nga ta kane marre kualifikimet ne disa nga keto vende. Shumica e profesoreve [80%] kane vizit ar Universitetin e Staffordshire, Britani e Madhe, Vaxjo Suedi, Vrie University ne Belgjike, Universiteti i Amsterdamit, Holande, Universiteti i Bambergut, Gjermani, Universiteti i Lublanes, Sloveni, Universiteti i Alcona, Universiteti i Alicante dhe Universiteti i Girones, Spanje etj. Qellimi i ketyre specializimeve te shkurtera eshte qe te rritet mundesi dhe kapacitet i mesimdhenesve ne rritjen e permiresimin e metodologjise se mesimdhenies.

### 7. Burimet materiale

Fakulteti dhe programi ne Ekonomiks kane salla te mjaftueshme, shume hapesire dhe pajisje te mira .psh. kompjutere dhe bibloteke per studentet [nese kjo do te ishte ne dispozion vetem te ketij programi]. Propozimi yne eshte qe per vitetet ne vazhdim fakulteti te blej me shume libra, raporte, studime etj dhe ti vere ato ne dispozion te studenteve. Kjo hapesire perdoret per te gjithe studentet e programit.

Hapesira e mesimdhenies per te gjithe studentet e prog amit eshte 3123 metra katrore dhe hapesira e disponueshme per nje person eshte 0,3123. Mirepo nese mbledhim numrin total te studenteve bachelor dhe master atehere hapesira na del e vogel.

Stafi akademik nga Departamenti i Ekonomiksit perdor p sjet te ndryshme ne proceset e tyre arsimore. Numri i kompjutereve eshte i mjaftues em, por numri i studenteve eshte teper i madh dhe ky mbetet nje problem i madh per stud dhe mesimdhenesit.

Ne mendojme qe numri i kompjutereve, projektoreve dhe e tjera eshte i majftueshme por rekomandimi yne kryesor eshte qe te pe miresohet hapesira per pune grupore gje qe do te permiresonte procesin akademil.

## 8. Studimet kerkimore shkencore

Sipas raportit te vet-vleresimit pothuajse te gjithe profesoret qe angazhohe ne mesimdhenie ne programin master ne Ekonomiks 'marrin jese ne studime shkencore. Stafi akademik formulon problemtatikat te cilat jane te nderlidhura dre teperdrejte me problematikat e sferes ekonomike ne Kosove. Keto projekte jane shume te rendesishme per ekonomine e Kosoves. Gjate periudhes 2009-2011, stafi akademik nga departamenti i Ekonomiksit kane marre pjese ne 8 konferenca nderkombetare dhe ne nje conference kombetare [Aneksi 1]. Keto raporte jane publikuar ne r ista shkencore nderkombetare. Si rezultat i punes se tyre ata kane publikuar artikuj, pergatitur raporte etj.

Por studentet e programit master ne Ekonomiks te programit master nuk kane patur mundesi te kontribojne ne projekte te kerkimit shkenco . Ne rekomandojme qe te perfshihen studentet ne keto projekte, sepse ne kete m nyre studentet jane ne gjendje te perfitojne pervoje dhe njohuri. Keto hulumtime duhet te jene te lidhura me ekonomine e Kosoves. Kerkuesit shkencor te rinj duhet te kene rezultate te mira arsimore per tu angazhuar ne pune kerkimore shkencore. Studentet mund te publikojne hulumtimet e tyre ne nje reviste shkencore mbrenda dhe jashte vendit si stimul ne kete drejtim.

Publikimet shkencore nderkombetare ne leter jane bere sisht nga profesoret me norme te plote. Proporcioni i pjesemarrjes se profesor e ne konferenca per nje profesor eshte 8:15. Publikimet shkencore mbrenda vendit per nje staf akademik jane 1:8.

Keto te dhena manifestojne qe publikimet mbrenda dhe e vendit jane te vogla. Ne rekomandojme qe te permiresohen indikatoret ne te ardhmen dhe te involvohen studentet ne kerkim shkencor. Menaxhmenti i shkolles po ben perpjekje qe studentet te publikojne hulumtimet e tyre, qe studentet te marrin pjese ne konferenca.

## 9. Vleresimi i njohurise se studenteve

Sistemi i vleresimit te studenteve rregulllohet ne nivel universitar dhe perfshin kushtet specifike te vleresimit te studentit gjate tere semestrit. Kontributi gjate gjithe ngarkeses se punes perben noten perfundimtare.

Edhe proporcioni i perqindjes se fituar gjate semestrit ne raport me provimin perfundimtar rregullohet nga Rregulloja e studimeve ne nivel institucioni. Ne konsiderojme qe menyra e ekzaminimit eshte e duhur.

Studentet duhet pergatitur tezen e diplomes ne perfundim te studimeve master.

**Rekomandim:**

1. Te akreditohet Programi Bachelor ne Ekonomiks
2. Te akreditohet Programi Master ne Ekonomiks
3. Te blihen libra, magazine dhe revista shkencore ekonomike ne gjuhe te ndryshme dhe nga vende te ndryshme dhe te jene te disponueshme ne Fakultetin Ekononik.
4. Fakuleti duhet te vazhdoj te bej permiresime ne staf duke promovuar stafin dhe shtuar ata ne studime te doktoratures dhe duke terhequr staf te kualifikuar kerkimor dhe per mesimdhenies ne specializimin e Ekonomiksit
5. Stafi akademik duhet te ngris numrin e publikimeve te e te librave, teksteve, monografive, studimeve dhe testeve.

# BSc. Banka, Financa dhe Kontabilitet / BSc ne Kontabilitet

### *Vleresim i pergjitheshem*

Sic eshte rasti me te gjitha programet e fakultetit, edhe programi bachelor ne Banka, Financa dhe Kontabilitet eshte ndertuar kryesisht mbi en e programeve te Universitetit te Lubjanes dhe Zagrebit. Bachelor ne Kontabilitet, ne vitin e dyte te operimeve eshte nje program i ngjashem me Universiteti e Arizones. .

Viti i pare i studimeve eshte e njejte per te dy progr met dhe i jep studentit nje rrjet te njohurive te ekonomise themelore afariste (si mikro dhe makroekonomi, matematike, statistika, Biznesi, E drejta, kontabiliteti, gjuha e huaj, etj.) Ne kater semestrat e mbetur kemi shtese te lendeve ne kuader te specializimeve.

Ne rastin e Bankave dhe Financave, Kontabilitet, fakuleteti llogarit ne kerkese te tregut te punes per te diplomuar me njohuri ne fushen e finane, nka, siguracioneve, buxhetit, doganes, financimit te tregtise nderkombetare, kontabi etin dhe kontabilitetin menaxherial.' Vitin e kaluar jane regjistruar 2309 studente [385 nga ta si part-time].

Ne rastin e programit te Kontabilitetit, kurrikula perfshin njohuri dhe mjeshteri qe priten nga i diplomuari qe punon ne departamente te kontabilitetit te kompanive. Rreth 114 studente me norme te plote jane regjistruar vitin e kaluar.

### *Krireteret e Evaluimit*

*Pergjigjet se pari do te ofrohen per Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe se dyti per Kontabilitet*

**• A korrespondojne programet akademike me misionin e i stitucionit dhe parimet e punesimit?**

- FE synon per te diplomuarit do te gjejne pune ne banka, komp e e sigurimeve dhe institucionet e tjera financiare. Kjo korrespondon me misionin e tij dhe ve theksin ne kontributin qe te diplomuarit japin drejt perparimit ekonomik dhe shoqeror ne Kosove. Nese nje numer relativisht i madh i te diplomuarve ne kete fushe te specializimit kerkohet ne tregun e punes eshte paksa veshtire te gjykohet pa patur njohuri te thelle rreth ekonomise se Kosoves.
- FE synon qe te diplomuarit te gjejne pune ne departamentet e kontabilitetit te kompanive. Ne mund te nxjerre nje perfundim te ngjashem: kjo korrespondon me misionin e saj dhe ne mund te supozojme qe ky profili te diplomuarve eshte e nevojshem ne ekonomine e Kosoves.

***A eshte cilesia, rangu dhe qellimet akademike te kurrikules te duhura per programin e ofruar?***

- Kurrikula eshte e duhur. Megjithate, dikush mund te vene ne pikepyetje diferencimin mes dy programeve bachelor. Program Bachelor ne Kontabilitet ka filluar vetem kohet e fundit. Duket se kurrikuli per B at, Financat dhe Kontabilitetin - nje program qe eshte ofruar per nje kohe tani - gjithashtu u perpoq per te akomoduar profilin e te diplomuarve qe fokusohet ne kontabilitet (kjo mund te konkludohet ne baze te rendesise se kurseve te kontabilitetit ne kurrikule dhe nga perfshirja e lendeve te tilla si Auditimi, Menaxhimi i NVM-ve krahass Nderrmarresise. Prandaj eshte e rekomandueshme te rishikohet ky program tani qe kemi nje program te specializuar ne Kontabilitet krahas ketij ne Banka, Financa dhe Kontabilitet.

- Po.

***A jane programet te bazuara ne nje koncept te unisuar didaktik dhe i cili eshte diskutuar dhe pranuar nga stafi mesimdhenes?***

- Rezultatet e te mesuarit identifikohen per secilen len dhe metodat e mesimdhenies perfshijne nje kombinim te ligjeratave dhe pune praktike, keshtu qe konceptet didaktike dhe zbtimi i tyre eshte I duhur.
- Si me larte

***A korrespondojne programet me standarde nderkombetare?***

- Sipas struktures se kurrikules programi aspiron per standarde nderkombetare
- Programi ne Kontabilitet bazohet ne programin e njejte ne Universitetin e Arizones dhe eshte pergatitur ne bashkepunim me profesoret e tye dhe natyrisht korrespondon me standardet nderkombetare.

***A ofron struktura e programeve mundesi te mjaftueshme er studim te pavarur, reflektim dhe analize?***

- Eshte veshtire te percaktohet koha qe studentet do ti erkushtojne mesimit te pavarir dhe reflektimit pa patur nje pershkrim te detajuar te qasjes se seciles lende. Mesimi ne distance dhe online nuk perfshihet.
- SI me larte

***A eshte bere alokimi i ECTS kredive ne menyre te duhur?***

- Po ne te dya rastet

***A eshte ngarkesa e menaxhueshme per studentet?***

- Nga ajo qe mund te gjykohet ne baze te materialeve te ponueshme, ngarkesa e studenteve ne kuptim te njesive qe duhet mbulohen es e menaxhueshme. Sidoqofte, nuk k ate dhena ne lidhje me progresin dhe hkallen e kompletimit per secilin program. Bazuar ne krahasimin e te dhenave te regjistrimit dhe diplomimit

ne mund te konkludojme qe progresi nuk eshte mjaft i l rte dhe nuk mund te cilesohet I knaqeshem.

- Si me larte.

***A jane metodat mesimore dhe permbajtja e njesive mesim re te mjaftueshme per arritjen e suksesshem te qellimeve dhe rezultateve (kompetencat dhe kualifikimet, njohurite dhe shkathtesite) te programit?***

- Po, ligjerata mbahen ne grupe prej 150 studenteve. Sidoqofte mesimi I perzier mund te perdoret poashtu. Gjykuar nga lista e literatures qe eshte ofruar, nje kombinim i literatures shqip dhe anglisht eshte ne perdorim.
- Si me larte [sidoqofte, ligjerata per Kontabilitet mbahen ne grupe prej 75 studenteve].

***A jane rregullat e provimeve te duhura?***

- Vleresimi I studenteve behet kryesisht ne provime me s rim si bashku me disa forma te vleresimeve mes-semestrale. Numri i hereve qe nje provim mund te ri-hyhet [tri here plus me shume ne raste te vecanta] lejon fleksibilitet te madh per studentet dhe ndoshta kontribon ne arsyen pse shkalla e progresit eshte e ulet.
- Si me larte.

***A eshte nderveprimi i permbajtjes akademike ndermjet rrikulave te ndryshme e kuptueshme dhe transparente?***

- Sic e kemi permendur edhe me heret, kurrikula e programit Banka, Financa, Kontabilitet nderthuret ne mase te madhe me kurrikulen e programit ne Kontabilitet. Prandaj, rekomandojme qe te rishqyrtoher kurrikula per kete program kur kihet parasysh fakti qe tashme kemi nje program te specializuar ne Kontabilitet.

***Si qendrojne kriteret dhe proceset e pranimit ne krahasim me standardet nderkombetare?***

Proceset e pranimit dhe kriteret jane transparente dhe te krahasueshme me standarde nderkombetare. Per shkak te numrit te madh te aplikanteve dhe procesi i pranimit ndihmon ne pranimin e studenteve me cilesi me te larte.

Si me larte.

***A eshte proporcioni student/staf i pershtateshem?***

- Proporcioni staf/student per shkollen ne teresi arrin  0:1. Anipse regjistrimi ne disa programe si Kontabiliteti nuk eshte I larte, shume lende ofrohen per te ted y programet bashke dhe kjo rezulton ne proporcione te pa-pershtateshme. Kjo eshte jo-produktive ne kuptim te mesimdhenies cilesore dhe ndik  n negativisht ne mundesine e kerkimitshkencor nga ana e stafit.
- SI me larte

**Rekomandimi i eksperteve:**

- Ne rekomandojme qe te rishqyrtohet pjesa e kontabilite it te ketij programi tashme qe kemi nje nje program te specializuar se voni ne Kontabilitet.
- Duhet monitoruar shkallen e progresit dhe kompletimit ne secilin program dhe te ofrohen masa adresuese te bazuara ne te dhena.
- Proporcioni student/staf eshte shume I larte.  Rekomandojme qe kjo ceshtje te adresohet ne te ardhmen.

# MSc. Banka, Financa, Kontabilitet

## *Vleresim i pergjitheshem*

Programi Master ne Banka, Financa, Kontabilitet ndertohen mbi bazen e programit Bachelor dhe ka fokusin e njejte. Kurrikula perfshin nje varg kursesh relevante per profiling e te diplomuarve qe deshirojne ne punojne ne sektorin banker, financiar dhe pershin edhe kurse ne kontabilitet dhe auditim.

Sipas raportit te vete-vleresimit, programi master i dedikohet studenteve qe ne te interesuar ne pune kerkimore shkenor. Programi ka regj r rreth 345 studente vitin e kaluar. Megjitjate, fokusi i proklamuar I kerkimit shkencor duket te bie ndesh me nje numer kaq te larte te studenteve.

## *Vleresim i kritereve*

***A korrespondojne programet akademike me misionin e institucionit dhe parimet e punesimit?***

- FE synon per te diplomuarit do te gjejne pune ne banka, kompanite e sigurimeve dhe institucionet e tjera financiare. Kjo k rrespondon me misionin e tij dhe ve theksin ne kontributin qe te diplomuarit apin drejt perparimit ekonomik dhe shoqeror ne Kosove. Nese nje numer relativisht i madh i te diplomuarve ne kete fushe te specializimit kerkohet ne tregun e punes eshte paksa veshtire te gjykohet pa patur njohuri te thelle reth ekonomise se Kosoves.
- FE synon qe te diplomuarit te gjejne pune ne departame e kontabilitetit te kompanive. Ne mund te nxjerre nje perfundim te ngjashem: kjo korrespondon

me misionin e saj dhe ne mund te supozojme qe ky profili i te diplomuarve eshte e nevojshem ne ekonomine e Kosoves.

***A eshte cilesia, rangu dhe qellimet akademike te kurri ules te duhura per programin e ofruar?***

- Kurrikula eshte e duhur. Megjithate, dikush mund te vene ne pikepyetje diferencimin mes dy programeve bachelor. Program Bachelor ne Kontabilitet ka filluar vetem kohet e fundit. Duket se kurrikuli pe  Bankat, Financat dhe Kontabilitetin - nje program qe eshte ofruar per nje kohe tani - gjithashtu u perpoq per te akomoduar profilin e te diplomuarve qe fokusohet ne kontabilitet (kjo mund te konkludohet ne baze te rendesise se kurseve te kontabilitetit ne kurrikule dhe nga perfshirja e lendeve te tilla si Aud timi, Menaxhimi i NVM-ve krahass Nderrmarresise.  Prandaj eshte e rekomandueshm  te rishikohet ky program tani qe kemi nje program te specializuar ne Ko   bilitet krahas ketij ne Banka, Financa dhe Kontabilitet.
- Po.

***A jane programet te bazuara ne nje koncept te unisuar didaktik dhe i cili eshte diskutuar dhe pranuar nga stafi mesimdhenes?***

- Rezultatet e te mesuarit identifikohen per secilen lende dhe metodat e mesimdhenies perfshijne nje kombinim te ligjeratave dh  pune praktike, keshtu qe konceptet didaktike dhe zbtimi i tyre eshte I duhur.
- Si me larte

***A korrespondojne programet me standarde nderkombetare?***

- Sipas struktures se kurrikules programi aspiron per standarde nderkombetare
- Programi ne Kontabilitet bazohet ne programin e njejte ne Universitetin e Arizones dhe eshte pergatitur ne bashkepunim me profesoret e tyre dhe natyrisht korrespondon me standardet nderkombetare.

***A ofron struktura e programeve mundesi te mjaftueshme er studim te pavarur, reflektim dhe analize?***

- Eshte veshtire te percaktohet koha qe studentet do ti perkushtojne mesimit te pavarir dhe reflektimit pa patur nje pershkrim te detajuar te qasjes se seciles lende. Mesimi ne distance dhe online nuk perfshihet.
- Si me larte

***A eshte bere alokimi i ECTS kredive ne menyre te duhur?***

Po ne te dya rastet

***A eshte ngarkesa e menaxhueshme per studentet?***

- Nga ajo qe mund te gjykohet ne baze te materialeve te isponueshme, ngarkesa e studenteve ne kuptim te njesive qe duhet mb hen eshte e menaxhueshme. Sidoqofte, nuk k ate dhena ne lidhje me rogresin dhe shkallen e kompletimit per secilin program. Bazuar ne krahasimin e te dhenave te regjistrimit dhe diplomimit ne mund te konkludojme qe progresi nuk eshte mjaft i larte dhe nuk mund te cilesohet I knaqeshem.
- Si me larte.

***A jane metodat mesimore dhe permbajtja e njesive mesimore te mjaftueshme per arritjen e suksesshem te qellimeve dhe rezultateve (kompetencat dhe kualifikimet, njohurite dhe shkathtesite) te programit?***

- Po, ligjerata mbahen ne grupe prej 150 studenteve. Sid qofte mesimi I perzier mund te perdoret poashtu. Gjykuar nga lista e literatures qe eshte ruar, nje kombinim i literatures shqip dhe anglisht eshte ne perdorim.
- Si me larte [sidoqofte, ligjerata per Kontabilitet mbahen ne grupe prej 75 studenteve].

***A jane rregullat e provimeve te duhura?***

Vleresimi I studenteve behet kryesisht ne provime me s rim si bashku me disa forma te vleresimeve mes-semestrale. Numri i hereve qe nje provim mund te ri-hyhet [tri here plus me shume ne raste te vecanta] lejon fleksibilitet te m per studentet dhe ndoshta kontribon ne arsyen pse shkalla e progresit eshte e ulet.

Si me larte.

***A eshte nderveprimi i permbajtjes akademike ndermjet rrikulave te ndryshme e kuptueshme dhe transparente?***

Sic e kemi permendur edhe me heret, kurrikula e programit Banka, Financa, Kontabilitet nderthuret ne mase te madhe me kurrikulen e programit Kontabilitet. Prandaj, rekomandojme qe te rishqyrtoher kurrikula per kete pro ram kur kihet parasysh fakti qe tashme kemi nje program te specializuar ne Kontabilitet.

***Si qendrojne kriteret dhe proceset e pranimit ne krahasim me stan ardet nderkombetare?***

Proceset e pranimit dhe kriteret jane transparente dhe te krahasueshme me standarde nderkombetare. Per shkak te numrit te madh te aplikanteve dhe procesi i pranimit ndihmon ne pranimin e studenteve me cilesi me te larte.

Si me larte.

***A eshte proporcioni student/staf i pershtateshem?***

Proporcioni staf/student per shkollen ne teresi arrin 0:1. Anipse regjistrimi ne disa programe si Kontabiliteti nuk eshte I larte, shume lende ofrohen per te ted y programet bashke dhe kjo rezulton ne proporcione te pa-pershtateshme. Kjo eshte jo-produktive ne kuptim te mesimdhenies cilesore dhe ndikon negativisht ne mundesine e kerkimitshkencor nga ana e stafit.

SI me larte

**Rekomandimet e eksperteve:**

- Meqe qellimi i programit master eshte qe te fokusohet kerkim shkencor te studentet e interesuar atehere do te ishte e udhes qe ofrohen mundesi me te medha per ta ne kete drejtim. Gjithashtu, vetem stafi ademik i cili eshte I kualifikuar dhe ben kerkim shkencor mund te udhezoj studentet e interesuar ne kerkim shkencor. Duhet perkushtuar dhe vene me teper theks tek kerkimi shkencor.
- Duhet adresuar ceshtjen e proporcionit student/staf
- Duhet monitoruar shkallen e progresit dhe diplomimit ne te ardhmen dhe te propozohen masa adresuese ne varesi te te dhenave.

# Msc. Nderrmarresi dhe Zhvillim Lokal

## *General Evaluation*

Programi MSc ne Ndermarresi dhe Zhvillimin Lokal u themelua 2 vjet me pare me mbeshtetjen e nje projekti te TEMPUS. Programi synon qe te pergatis te diplomuarit qe te punojne ne ministry, komuna dhe institucione tjera qe mbeshtesin sipermarrjen dhe ne komunitetin e biznesit.Programi aktualisht pranon nga studente me norme te plote. Duke pasur parasysh rendesine e sipermarrjes per rritjen ekonomike, Kosova duhet te perfitoje nga nje program qe prodhon te diplomuar qe kuptojne mbeshtetjen qe NVM-te kerkojne dhe implikimin e ketyre politikave. Programi rfshin disa kurse qe jane ne interest e drejteperdrejte te sipermarresve si menaxhimi i NVM-ve, Studim tregu per NVM-te, Kontabiliteti financiar per NVM-te, Menaxhimi i sistemeve te informacionit]. Sipas stafit interesi i studenteve per nje program te lle eshte mjaft I larte. Pas nje kohe maturimi ndoshta edhe ky program duhet te rishqyrtoj fokusin e tij. Nje program qe fokusohet tek sipermarresit e ardhshem ne tregun e synuar (ne vend te politikeberesve) mund te jete me interesant per studentet (por kjo eshte e veshtire per te gjykuar pa nje njohuri te thella te ekonomise Kosovare)

## *Criteria Evaluation*

***A korrespondojne programet akademike me misionin e ins tucionit dhe parimet e punesimit?***

Po, programi korrespondon me misionin e fakultetit dh eve theksin ne te diplomuarit qe mund te ndihmojne avancimin e progresit ekonomik dhe social ne Kosove.

***A eshte cilesia, rangu dhe qellimet akademike te kurri ules te duhura per programin e ofruar?***

Kurrikula eshte e duhur. Rezultatet e te mesuarit identifikohen per secilen lende dhe metodat e mesimdhenies perfshijne nje kombinim te ligjeratave dhe pune praktike, keshtu qe konceptet didaktike dhe zbatimi i tyre eshte i duhur. Si nje program master, programi duhet te kete me shume focus ne detyra indivi ale dhe grupe per kerkim shkencor. Ky qellim mund te arrihet pasi numri I studenteve eshte I pranueshem.

***A korrespondojne programet me standarde nderkombetare?***

Sipas struktures se kurrikules programi aspiron per st ndarde nderkombetare

***A ofron struktura e programeve mundesi te mjaftueshme er studim te pavarur, reflektim dhe analize?***

Eshte veshtire te percaktohet koha qe studentet do ti perkushtojne mesimit te pavarir dhe reflektimit pa patur nje pershkrim te detajuar te qasjes se seciles lende. Mesimi ne distance dhe online nuk perfshihet.

***A eshte bere alokimi i ECTS kredive ne menyre te duhur?***

Po

***A eshte ngarkesa e punes ne kuader te programit akadem k e menaxhueshme?***

Nga ajo qe mund te gjykohet nga materalet e ofruara, ngarkesa e punes per studentet duket te jete e menaxhueshme. Sidoqofte, nuk ka te dhe ne lidhje me shkallen e progresit dhe kompletimit per programin.

***A jane metodat mesimore dhe permbajtja e njesive mesim re te mjaftueshme per arritjen e suksesshem te qellimeve dhe rezultateve (kompetenca dhe kualifikimet, njohurite dhe shkathtesite) te programit?***

Gjykuar nga listat ee ofruara mund te konkudohet se perdoret vetem literature ne gjuhen angleze por kjo duhet te jete e menaxhueshme per studimet master [literature ne disa kurse nuk ishte e disponueshme]. Meqe objektivat e mes mnxenies nuk ekzistojne per secilen lende, atehere permbajtja e njesive mund te gjykohet vetem ne baze te pershkrimeve te ofruara. Bazuar ne kete ne mund te themi qe mesimdhenies I ndjek objektivat e programit duke mbuluar ceshtje te rendesishme zhvillimore dhe politike dhe duke perfshire ceshtje qe jane relevante per studentet qe deshirojne te themelojne biznese te sukeseshme.

***A jane rregullat e provimeve te duhura?***

Vleresimi I studenteve behet kryesisht ne provime me shkrim si bashku me disa forma te vleresimeve mes-semestrale. Numri i hereve qe nje provim mund te ri-hyhet [tri here plus me shume ne raste te vecanta] lejon fleksibilitet te madh per studentet dhe ndoshta kontribon ne arsyen pse shkalla e progresit eshte e ulet.

***A eshte nderveprimi i permbajtjes akademike ndermjet urrikulave te ndryshme e kuptueshme dhe transparente?***

Po

***Si qendrojne kriteret dhe proceset e pranimit ne kraha im me standardet nderkombetare?***

Proceset e pranimit dhe kriteret jane transparente dhe te krahasueshme me standarde nderkombetare. Per shkak te numrit te madh te aplikanteve dhe procesi i pranimit ndihmon ne pranimin e studenteve me cilesi me te larte.

***A eshte proporcioni staf/student i duhur?***

Meqe programi regjistron vetem 50 studente [dhe aktualisht kemi 35] proporcioni cilesohet si i pershtateshem.

**Rekomandimi i eskerteve:**

- Meqe ky program master ve theksin ne kerkim shkencor atehere duhet ofruar me shume mundesi qe studentet te kqyqen ne detyra te kerk mit shkencor. Ne anen tjeter vetem stafi akademim I kualifikuar dhe qe vet eshte I angazhuar ne kerkim shkencor mund te jete ne gjendje te udhezoj proceset e kerimit shkencor per studentet. Shi per kete duhet dedikuar me shume rendes kerkimit shkenor.
- Duhet monitoruar shkallen e progresit dhe kompletimit lendeve per studentet, sikurese edhe kerkesa nga tregu I punes dhe te behen permiresime aty ku kerkohet.

# BSc. Menaxhment dhe Informatike / Bsc Marketing

Pergjigjet ofrohen fillimisht per informatike dhe past j per marketing

## Pasqyre e programit

**A korrespondojne programet akademike me misionin e ins itucionit dhe parimet e punesimit?**

- Po. Programi Bsc ne Menaxhment dhe Informatike synon p e mesme dhe kryesore ne menaxhimin e NVM-ve, sektorin publik dhe ate privat. Kemi kerkese sidomos nga bankat dhe sektori i siguracioneve. Programi eshte I definuar dhe objektivat e pergjithshme na u paraqiten gjate vizites ne terren. Pjese e vizionit ishte edhe qe te diplomuarit te themelojne biznese te reja ne vend dhe rajon.
- Po. Programi BSc ne Marketing synon menaxhmentin e mesem dhe te larte te NVM-ve, sektorin privat dhe ate public. Kemi kerkese kryesisht nga sektori bankar dhe siguracioneve. Programi eshte I definuar dhe objektivat e pergjithshm na u paraqiten gjate vizites ne terren. Pjese e vizionit ishte edhe qe te diplomuarit te themelojne biznese te reja ne vend dhe rajon..

***A eshte cilesia, rangu dhe qellimet akademike te kurri ules te duhura per programin e ofruar?***

- Cilesia, rangu dhe qellimet jane te duhura per programin. Gjate bisedave me student kuptuam se ka hapesire per permiresim te mundesive per internship. Per shkak te kushteve jo te mira te tregut te punes eshte eshtire te gjendjen mundesi per nje numer kaq te madh te studenteve, por perfshirj e ketij opcioni ne permbajtje do ta pasuronte programin.

- Cilesia, rangu dhe qellimet jane ne mase te madhe te duhura. Mjeshtrite e buta dhe ato nder-kulturore nuk ofrohen si pjese e programit. Keto ceshtje adresohen paksa ne lenden e sjelljes se konsumatorit. Meqe shum studente kane mundesine te punojne jashte vendit atehere eshte e ren esishme qe te perfshihen keto lende. Gjate bisedave me student ne p mundesine te

kuptojme qe nuk ka mundesi te mjaftueshme per internship. Per shkak te kushteve jo te mira ne tregun e punes eshte veshtire t gjenden mundesi per te gjithe mirepo kjo mundesi me kredi ECTS do ta pasuronte programin.

***A jane programet te bazuara ne nje koncept te unisuar didaktik dhe i cili eshte diskutuar dhe pranuar nga stafi mesimdhenes?***

- Koncepti i pergjitheshem didaktik eshte percaktohet ne nivel fakulteti.Sidoqofte cdo profesor duket te kete fleksibilitet deri ne nje mase te caktuar.

- E njejta vlen edhe per Marketing.

***A korrespondojne programet me standarde nderkombetare?***

- Stafi mban lidhje me programet nderkombetare ne forme e praktikave te mira. Pershtatja ndaj kushteve lokale eshte bere permes disa lendeve. Rreth 10% e studenteve vazhdojne studimet Master. Disa studente kane fituar bursa studimi ne universitete boterore.
- Programi akademik korrespondon me standardet nderkombetare [Bolonjes].

***A ofron struktura e programeve mundesi te mjaftueshme per studim te pavarur, ref ektim dhe analize?***

- Se voni eshte shtuar edhe lenda e shkrimit akademik dhe ky eshte nje zhvillim i rendesishem. Nje internship me vlere 6 ECTS nuk duket kund ne kurrikule. Shumica e tezave te diplomes zhvillohen ne kompani dhe keto jane rreth 20-30 faqe dhe perfshijne rreth 5-10 referenca.
- Mesimi i perzier dhe e-mesimi nuk perdoren gjeresisht
- E njejta vlen edhe per Marketing.

***A eshte bere alokimi i ECTS kredive ne menyre te duhur?***

- Po, mirepo menyra e alokimit eshte koxha mekanike dhe kemi edhe menyra tjera qe do te reflektonin format e mesimdhenies dhe sipas r ndesise se kurseve [numri i oreve duhet te korrespondon me kredite ECTS].

***A eshte ngarkesa e menaxhueshme per studentet?***

- Vetem 10% e studenteve perfundojne studimet mbrenda afatit dhe rreth 10-20 % ndalojne studimet. Fakulteti duket se nuk mban te dhe ne menyre sistematike per indikatoret e performances dhe si rezultat patem pergjigje te ndryshme ne kete ceshtje nga stafi, menaxhmeti, profesoret dhe studentet.
- E njejta vlen edhe per Marketing.

***A jane metodat mesimore dhe permbajtja e njesive mesim re te mjaftueshme per arritjen e suksesshem te qellimeve dhe rezultateve (kompetencat dhe kualifikimet, njohurite dhe shkathtesite) te programit?***

- Po ne pergjithesi. Metodat e mesimdhenies perfshijne etem mundesi te limituara per internship. Prezentimet nga te diplomuarit dhe vizitat ne kompani rdoren por jo shpesh dhe jo per numer te madh studentesh.
- Materilet e ligjerimit te pershkruara ne raport nuk jane te perditesuara. Sipas diskutimeve ne terren mesimdhenesit perdorin tekste ne gjuhen angleze dhe studentet duhet blere materialet. Disa nga tekstet e permendura ne raport jane shume te vjetra.
- Stafi ka vene theksin ne ndertimin e amfiteatrove te reja dhe hapesire te shtuar per te plotesuar nevojat. Kjo eshte e rendesishme per stabilizuar operacionet. Edhe laboratori i kompjutereve duhet persosur tutje pe programin e informatikes. Jo te gjithe studentet kane lap top te tyre .
- E njejta vlen edhe per Marketing.

***A jane rregullat e provimeve te duhura?***

- Permbajtja e vitit te pare eshte e njejte per te gjith studentet. Pjese e strategjise eshte qe te gjitha programet jane paksa te ngarkuara n vitin e pare me kurse kerkuese ne menyre qe vetem ata me te fortit te mbijetojne.
- Edhe nese nje student bjen ne provim tri here radhazi Komision in caktuar mund te jap lejen edhe per privime shtese. Nuk duket ete rregulla te qarta per kete ceshtje.

***A eshte nderveprimi i permbajtjes akademike ndermjet kurrikulave te ndryshme e kuptueshme dhe transparente?***

- Ligjerat e vitit te pare realizohen ne grupe shume te edha. Kjo realizohet ne bashkepunim me programet tjera BSc.
- E nejta vlen edhe per BSc Marketing.

***Si qendrojne kriteret dhe proceset e pranimit ne krahasim me standardet nderkombetare?***

- Kriteret e pranimit jane te krahasueshme me vendet e tjera. Fakulteti Ekonomik eshte shume I popullarizuar dhe kane aplikante te mire.
- E njejta vlen edhe per BSc Marketing.

***A eshte proporcioni student/staf i pershtateshem?***

- Jo. Vitin e ardheshem parashihet te pranohen 450 stud nte dhe kjo do te rezultoj ne nje numer prej 3000 studente. Bazuar ne diskutimet gjate vizites ne terren kjo I tejkalon kapacitetet ekzituese per rreth 50%.
- Proporcioni staf/student eshte 1:130 dhe kjo eshte larg mesatare se OECD-se. Menaxhmenti duhet te marra masa urgjente te zvogloj numrin e studenteve ne menyre qe te mos ndikoj negativisht ne cilesi. Ushtrimet dhe keshillimet mund te realizohen nga asistentet per grupe 30-50 studente qe eshte me e menaxhueshme.

- Jo. Vitin e ardheshem parashihet te pranohen 250 stud nte dhe kjo do te rezultoj ne nje numer prej 3000 studente. Bazuar ne diskutimet gjate vizites ne terren kjo I tejkalon kapacitetet ekzituese per rreth 50%.
- Proporcioni staf/student eshte 1:130 dhe kjo eshte larg mesatares se OECD-se. Menaxhmenti duhet te marra masa urgjente te zvogloj numrin e studenteve ne menyre qe te mos ndikoj negativisht ne cilesi. Ushtrimet dhe keshillimet mund te realizohen nga asistentet per grupe 30-50 studente qe eshte me e menaxhueshme.

**Rekoamndimi i eksperteve:**

- Burimet per mesimdhenie duhet te avancohen nga 1:130 ne nje mesatare prej 1:30 ose 1:25. Menaxhmenti duhet te propozoj nje plan gjate per te adresuar kete. Proporcioni aktual nuk eshte i menaxhueshem.
- Duhet te kemi nje sistem per mbledhjen e opinioneve ng diplomuarit
- Duhet te instalohet 'mesimi i perziet 'ne menyre qe te zvogelohet ngarkesa e punes. Nje sistem Moodle ne nivel fakulteti mund te instalohet.
- Puna praktike dhe intershipi duhet vene theks me te vecante
- Duhet te kemi nje plan te qarte te rekrutimit te stafi dhe balancimit te tij me regjistrim te studenteve
- Duhet perfshire lendet qe avancojne aftesite e buta dh nderkulturore posaqerisht per programin e Marketingut
- ECTS duhet te jene me te diferencuara
- Rregullat per provimet duhet te jene te qarta dhe perpjekjet maksimale per nje provim te caktuar duhet te jene te qarta.

# MSc. Menaxhment dhe Informatikeg / Msc Marketing

Pergjigjet jipen fillimisht per informatike dhe Marketing

## Pasqyre e programeve

***A korrespondojne programet akademike me misionin e institucionit dhe parimet e punesimit?***

- Msc ne Menaxhment dhe Informatike ka synim pergatitjen e stafit per rol udheheqes ne kompani. Krahasuar me nivelin BSc, ketu fokusi eshte kryesisht ne nivelin e menaxhmentit te larte. Per kete arsye eshte rfshire edhe lenda e Lidershipit dhe sjelljes organizative. Te diplomuarit te jene ne gjendje te punojne ne pune praktike dhe zgjedhje te problemeve.
- E njejta vlen edhe per MSc Marketing

***A eshte cilesia, rangu dhe qellimet akademike te kurri ules te duhura per programin e ofruar?***

Sipas materialeve te ofruara ne raport te vete-vleresimit dhe diskutimeve ne terre, programi eshte i krahasueshem me standarde nderkombetare.

***A jane programet te bazuara ne nje koncept te unisuar didaktik dhe i cili eshte diskutuar dhe pranuar nga stafi mesimdhenes?***

Nuk eshte e qarte

***A korrespondojne programet me standarde nderkombetare?***

Po. Sipas materialeve te ofruara dhe vizites ne terren mund te konkludojme qe programi eshte ne pajtueshmeri me standardet nderkombetare. Kerkesat per ligjerata, detyra dhe permbajtje te tezes se diplomes jane te krahasueshme me programme tjera biznesore te ketij niveli.

***A ofron struktura e programeve mundesi te mjaftueshme per studim te pavarur, re lektim dhe analize?***

- Shumica e studenteve punojne krahas procesit te studimit dhe ligjeratat ne program behen gjate oreve te vona. Vikendet perdoren per provime. Mjetet e mesimit ne distance perdoren kohe pas kohe [nje web faqe per shkarkim te materialeve]. Poashtu kemi edhe profesor visitor.
- E njejta vlen edhe per Msc Marketing

***A eshte bere alokimi i ECTS kredive ne menyre te duhur?***

Po

***A eshte ngarkesa e menaxhueshme per studentet?***

Po. Per studentet me norme te plote eshte ne rregull, mirepo per ata me gjysem norme pak me veshtire.

***A jane metodat mesimore dhe permbajtja e njesive mesim re te mjaftueshme per arritjen e suksesshem te qellimeve dhe rezultateve (kompetenca dhe kualifikimet, njohurite dhe shkathtesite) te programit?***

Permbajtja ne nivelin MSc perfshin me shume material teorike dhe duket se kemi nje ndarje te qarte ndermjet niveleve Bsc dhe Msc. Perdorimi i mejteve te kerkimit shkencor dhe metodave per analize statistikore ju jap mundesi studenteve te marrin njohuri te duhura per kete pozicion. Kombinimi I metodave te perd rura: provimi konceptual per pjesen teorike, protofolet, detyrat dhe seminaret orga zohen me rregull.

E njejta vlen edhe per MSc Marketing.

- ***A jane rregullat e provimeve te duhura?***

Provimet ne nivelin master jane te krahasueshme me pro rame nderkomnetare. Procesimi i punes se tezes se diplomes duket paska byrokratike dhe involvon disa hapa te raportimit.

- E njejta vlen per programin Msc Marketing

***A eshte nderveprimi i permbajtjes akademike ndermjet kurrikulave te n ryshme e kuptueshme dhe transparente?***

Po

***Si qendrojne kriteret dhe proceset e pranimit ne krahasim me standardet nderkombetare?***

Rreth 10% te studenteve vijne nga fakultete tjera mbrenda UP-se. Numri total i studenteve eshte 150. Vetem 10% e studenteve vijne nga olegjet tjera jashte UP-se. Te tjeret 80% jane nga programet e fakultetit.

[MSc Marketing] Numri I studentet eshte zyrtarisht 80, por ne fakt kemi me shume. Rreth 10% te studenteve vijne nga fakultete tjera mbrenda UP-se. Numri total i studenteve eshte 150. Vetem 10% e studenteve vijne nga Kolegjet t a jashte UP-se. Te tjeret 80% jane nga programet e fakultetit

***A eshte proporcioni student/staf i pershtateshem?***

Proporcioni staf/student mbetet problematic ne nivelin master poashtu. Duke qene qe numri I studenteve ka tejkaluar 100 per nje nivel mate atehere mund te themi qe ngarkesa eshte veshtire e menaxhueshme dhe nuk korresp ndojne me standard nderkombetare. Fakulteti duhet te kete nje plan te menaxhimit te rritjes dhe involvimit te metodave te reja te mesimdhenies.

E njeta vlen edhe per programin MSc Marketing.

**Rekomandimet e eksperteve:**

- Shqetesimi kryesor per programin MSc mbetet numri i larte i studenteve krahas atij te stafit. Ne nivelin master parashihet bashkepunim me i madh ndermjet studenteve dhe stafit dhe kjo duhet te mirret parasysh ne kete aspekt.

- Krahas investimeve te kerkura ne infrastrukture dhe objekte poashtu kerkohen investime dhe risktrukturim i pajisjeve te IT. Klasat duhet te pajisjet me softuer adekuat [Office, SPSS, STATA] dhe duhet te jene te per htatshme per grupe te vogla.
- Duhet te kete nje sistem sistematik per marrjen e opinioneve te te diplomuarve ne menyre qe te monitorohet zhvillimi dhe menaxhimi i programeve dhe lendeve.
- Studentet e nivelit master duhet te kene qasje ne revista shkencor elektronike si Athens dhe Science Direct.
- Ne shume vende te BE-se ligjeratat jipen ne gjuhen angleze. Na u tha qe lig eratat do te jipen se shpejti edhe ne gjuhen angleze. Kjo duhet te realizohet sa me shpejte qe te jete e mundur.
- Qendra e kerkimit shkencor dhe praktika e recenzimit te punes shkencor dhe revistes shkencor duhet te instalohet sa me shpejte.

# Studimet e Doktoratures

## Pasqyre

- Fakulteti eshte duke kaluar ne fazen e strukturimit dhe transformimit te studimit te doktoratures. Eshte nxjerrur thirrja per pranimin e 4 studenteve duke filluar nga Shtatori 2012.
- Procesi i selektimit eshte ne proces: kemi tri kritere themelore (1) notat, (2) testi i anglishtes dhe (3) publikimet
- Te gjithe studentet duhet ti kene kaluar mikro dhe mak o ekonimine dhe metodologjine e lendeve gjegjese dhe pastaj te kalojne kah specializimi dhe kompletimi i tezes se diplomes me pune individuale
- Ekziston kushti qe secili student te publikoj ne nje reviste shkencore me nume te akreditua ISSN
- Insituti i kerkimit shkencor ende nuk eshte operacional dhe duket se nuk kemi ndonje mbeshtetje sistematike per realizimin e projekt te kerkimit shkencor. Per shembukl, kontrata e punes se UP-se jane vetem per mesimdhenie
- Mundesite e financimit dhe bashkepunimit nderkombetar ne te limituara.

**Rekomandimet e eksperteve:**

- Fakulteti duhet te mbaj regjister te projekteve te kerkimit shkencor dhe publikimeve te kompletuara nga profesoret dhe studentet PHD. Fakulteti duhet te inkurajoj keto aktivitete duke vleresuar kerkimin shkencor krahas mesimdhenies. Pa plotesuar keto para-kushte rrezikohet qe kerkimi shkencor te jete i fragmentuar dhe individual apo edhe si pjese e ndonje institute tjeter.
- Fakulteti duhet te instaloj praktikes e marrjes pjese aktivitete te kerkimit shkencor nderkombetar dhe ti mbeshtes ato. Kemi fonde ropiane ne dispozicion qe mbeshtesin aktivitete te tilla por kjo erkon pune. Studentet e doktoratures dhe magjistratures duhet te angazhohen ne kete drejtim
- Duhet te perdoret bibloteka elektronike per te arkivua tezat e diplomes se nivelit te doktoratures
- Duhet siguruar qasje ne databazat elektronike si Athens apo Science Direct

- Qendra e kerkimit shkencor e planifikuar me heret duhet te themelohet se bashku me revisten shkencor me praktiken e recenzimit sa me shpejte qe te jete e mundur.

.

# Konkluzionet

## Pjesa I Akreditimi institucional

Fakulteti Ekonomik duhet te kete akreditim institucional. Sidoqofte, kemi nje prapambetja ne numrin e ulet te profesoreve, profesore e te asociuar dhe stafit tjeter te angazhuar ne punen me studente ne te gjitha nivelet [Bachelor, Master, Doktorature] sipas nivelit ted he kornizes se procesit te Bolonjes. Universiteti duhet te trajtoje kete ceshtje ne menyre serioze dhe te mos lejoj qe kjo te ndikoj negativisht ne programet dhe cilesine e tyre. Ne te kunderten program nuk duhet ofruara apo pergjysmuar.

Eshte esenciale qe te permiresohet puna ne kerkim shkencor ne menyre qe kjo te rris cilesine dhe qendrueshmerine e fakultetit. Do te e dobishme qe te involvohen studentet bachelor dhe master ne kete proces. Studentet do te donin nje mundesi te tille. Rritja dhe permiresimi i kerkimit shkencor do te mundesonte publikime te reja ne forme te librave, teksteve, punimeve dhe artikujve shkencor si mbrenda ashtu edhe jashte vendit. Nje qender per kerkim shkencor do te ishte ne gjendje te mbeshtes keto zhvillime duke ju mundesuar stafit te participoj ne konferenca dhe simpoziume. Kerkohen investime te medha ne infrastrukture dhe posacerisht ne objekte per mesimdhenie [klasa te vogla dhe numer te mjaftueshem te librave ne bibloteke dhe eksplorimi i mundesive online].

Fakulteti duhet te konsideroj edhe pika te vecanta te a ne nen-seksionet e mesiperme. Nje diskutim i thukte do te ndihmonte ne zh limin e fakultetit dhe ngritjen e tij ne nje nivel te qendrueshem.

# Pjesa II Akreditimi i programeve

## Programet ne Ekonomiks

§ Bachelor

Te akreditohet programi ne Ekonomiks - Bachelor;

§ Master

Te akreditohet programi Ekonomiks - Master.

- Komentet shtese

Duhet blere libra, magazine dhe revista per Ekonomiks gjuhe te ndryshme dhe nga vendet te ndryshme dhe ato te jene te disponueshme ne bibloteke te Fakultetit.

Fakulteti dhe departamenti duhet vazhduar perpjekjet per permiresimt te stafit akademik duke promovuar stafin ne nivel doktorate apo nivel tjera dhe te vazhdoj te terhqe staf shkencor dhe me fame per specializimet e Ekonomiksit.

Stafi akademik duhet te rris numrin e publikimeve te tyre ne forme te librave, teksteve, nonografive, studimeve dhe testeve.

## Programet ne Banka, Financa, Kontabilitet / Kontabilitet

- Bachelor

Diferencimi i elementit te kontabilitetit ne kuader te programit Banka, Financa dhe Kontabilitet duhet te rishqyrtohet tashme qe kemi nje program te vecante ne Kontabilitet.

Shkalla e kompletimit te lendeve dhe progresit duhet m r vazhdimisht dhe te behen permiresime ne menyre sistema ike varesisht prej rezultateve.

Proporcioni staf/student eshte teper i larte, dhe kerkohet qe kjo ceshtje te adresohet ne te ardhmen.

- Master

Meqe qellimi i programit master eshte qe te inkuadroje studente me interes per kerkim shkencor atehere eshte e udhes qe t kemi me shume mundesi per kerkim shkencor. Gjithashtu, vetem stati akademik qe realizon vet projekte te kerkimit shkencor mund te ene ne gjendje te udherrefejne procesin e kerkimit shkencor tek studentet. Duhet vene theks te vecante tek aktivitetet e kerkimit shkencor ne fakultet.

Rekomandojme qe te adresohet ceshtja e proporcionit te papershtatshem staf/student.

Shaklla e progresit dhe kompletimit te lendeve duhet t monitorohet krahas monitorimit te zhvillimeve dhe te dhenave te tr gut te punes dhe te behen permiresime ku te jete nevoja.

.

## Programi ne Nderrmarresi dhe Zhvillim Lokal

- Master

Meqe programi synohet per studente me interes ne kerikim shkencor atehre eshte e udhes qe te kemi me shume mundesi per kerkim shkencor per studentet. Gjithashtu, vetem stati akadem qe realizon vet projekte te kerkimit shkencor mund te jene ne gjendje te udherrefejne procesin e kerkimit shkencor tek studentet. Duhet vene theks te vecante tek aktivitetet e kerkimit shkencor ne fakultet.

Shaklla e progresit dhe kompletimit te lendeve duhet t monitorohet krahas monitorimit te zhvillimeve dhe te dhenave te tregut te punes ne menyre qe ky program i orientuar kah zhvillimi i njohurive dhe mjeshterive i te qenurit nderrmarres –dhe keto te dhena te perdoren ne menyre sistematike per te permiresuar dhe perditesuar programin.

## Programet ne Menaxhment dhe Informatike / Marketing

### Bachelor

- Burimet per mesimdhenie duhet te avancohen nga 1:130 ne nje mesatare prej 1:30 ose 1:25. Menaxhmenti duhet te propozoj nje plan egjate per te adresuar kete. Proporcioni aktual nuk eshte i menaxhueshem.
- Duhet te kemi nje sistem per mbledhjen e opinioneve ng e diplomuarit
- Duhet te instalohet 'mesimi i perziet 'ne menyre qe te zvogelohet ngarkesa e punes. Nje sistem Moodle ne nivel fakulteti mund te instalohet.
- Puna praktike dhe intershipi duhet vene theks me te vecante
- Duhet te kemi nje plan te qarte te rekrutimit te stafi dhe balancimit te tij me regjistrim te studenteve
- Duhet perfshire lendet qe avancojne aftesite e buta dh nderkulturore posaqerisht per programin e Marketingut
- ECTS duhet te jene me te diferencuara
- Rregullat per provimet duhet te jene te qarta dhe perpjekjet maksimale per nje provim te caktuar duhet te jene te qarta.

### Master

- Shqetesimi kryesor per programin MSc mbetet numri i la te i studenteve krahas atij te stafit. Ne nivelin master parashihet bashkepunim me i madh ndermjet studenteve dhe stafit dhe kjo duhet te mirret parasysh ne kete aspekt.
- Krahas investimeve te kerkura ne infrastrukture dhe ob ekte poashtu kerkohen investime dhe risktrukturim i pajisjeve te IT. Klasat duhet te pajisjet me softuer adekuat [Office, SPSS, STATA] dhe duhet te jene te pershtatshme per grupe te vogla.

- Duhet te kete nje sistem sistematik per marrjen e opi neve te te diplomuarve ne menyre qe te monitorohet zhvillimi dhe enaxhimi i programeve dhe lendeve.
- Studentet e nivelit master duhet te kene qasje ne revi ta shkencor elektronike si Athens dhe Science Direct.
- Ne shume vende te BE-se ligjeratat jipen ne gjuhen angleze. Na u tha qe ligjeratat do te jipen se shpejti edhe ne gjuhen angleze. Kjo duhet te realizohet sa me shpejte qe te jete e mundur.
- Qendra e kerkimit shkencor dhe praktika e recenzimit t punes shkencor dhe revistes shkencor duhet te instalohet sa me shpejte.

## Programet ne Shkenca Ekonomike

PhD

- Fakulteti duhet te mbaj regjister te projekteve te kerkimit shkencor dhe publikimeve te kompletuara nga profesoret dhe studentet PHD. Fakulteti duhet te inkurajoj keto aktivitete duke vleresuar kerkimin shkencor krahas mesimdhenies. Pa plotesuar keto para-kushte rrezikohet qe kerkimi shkencor te jete i fragmentuar dhe individual apo edhe si pjese e ndonje institute tjeter.

- Fakulteti duhet te instaloj praktikes e marrjes pjese aktivitete te kerkimit shkencor nderkombetar dhe ti mbeshtes ato. Kemi fonde vropiane ne dispozicion qe mbeshtesin aktivitete te tilla por kjo kerkon pune. Studentet e doktoratures dhe magjistratures duhet te angazhohen ne kete drejtim

- Duhet te perdoret bibloteka elektronike per te arkivua tezat e diplomes se nivelit te doktoratures. Duhet siguruar qasje ne databazat elektronike si Athens apo Science Direct

- Qendra e kerkimit shkencor e planifikuar me heret duhet te themelohet se bashku me revisten shkencor me praktiken e recenzimit me shpejte qe te jete e mundur.